




INSTRUMENTI PËR ASISTENCËN E PARA-ANËTARËSIMIT (IPA II)



DOKUMENT STRATEGJIK
indikativ
PËR SHQIPËRINË
(2014-2020)

Miratuar më 18.08.2014

PASQYRA E LËNDËS

PJESA I: HYRJE	3
1. Qëllimi	3
2. Konsultimet për këtë Dokument Strategjik	4
PJESA II: ANALIZA E NEVOJAVE DHE KAPACITETEVE	4
1. Konteksti politik dhe ekonomik	4
2. Konteksti për planifikimin e asistencës	7
PJESA III: SKEMA E ASISTENCËS SË PARA-ANËTARËSIMIT PËR SHQIPËRINË	11
PJESA IV: ASISTENCA E BE-SË PËR PERIUdhËN 2014-2020	14
1. Demokracia dhe qeverisja	14
2. Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore	18
2.1 Drejtësia dhe të drejtat themelore	18
2.2 Çështjet e brendshme	21
3. Mjedisi dhe masat për klimën	23
4. Transporti	27
5. Konkurrueshmëria dhe novacioni	30
6. Arsimi, punësimi dhe politikat sociale	32
7. Bujqësia dhe zhvillimi rural	34
8. Bashkëpunimi territorial dhe bashkëpunimi rajonal	37
SHTOJCA 1: ALOKIMET INDIKATIVE (MILION EUR) SIPAS FUSHËS DHE SEKTORIT	40
SHTOJCA 2: INDIKATORËT DHE OBJEKTIVAT	41

PJESA I: HYRJE

1. Qëllimi

Ky Dokument Strategjik Indikativ (Dokumenti Strategjik) përcakton prioritetet e asistencës financiare të BE-së për periudhën 2014-2020 për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit. Ai përkthen prioritetet politike të përcaktuara në kuadrin e politikës së zgjerimit në fusha kyçe ku asistenca financiare është më e dobishme për të përmbushur kriteret e anëtarësimit. Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)¹ është instrumenti kryesor financiar përmes të cilit BE-ja mbështet përfituesit në zbatimin e reformave me qëllim anëtarësimin në BE. Asistenca financiare në kuadër të IPA II ndjek katër objektiva specifike si më poshtë: (a) mbështetje për reformat politike, (b) mbështetje për zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, (c) forcim i aftësisë së përfituesve të renditur në Shtojcën I për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE, duke mbështetur përafrimin gradual si dhe zbatimin e miratimit të *acquis* të BE-së, (d) forcim i integritetit rajonal dhe bashkëpunimit territorial. Për më tepër, Rregullorja II IPA thekson se ndihma financiare do të trajtojë kryesisht pesë fusha politikash: a) reformat në përgatitje për anëtarësim në BE si dhe forcimin institucional dhe të kapaciteteve që nevojitet në këtë drejtim, b) zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal, c) punësimi, politikat sociale, arsimit, nxitja e barazisë gjinore dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, d) zhvillimi bujqësor dhe rural, dhe e) bashkëpunimi rajonal dhe territorial.

Në mënyrë që të rrisë ndikimin e saj, asistenca financiare e BE-së do të përqendrohet në fusha ku reformat apo investimet janë më të nevojshme për të përmbushur kriteret e anëtarësimit, si edhe do të përshtatet sipas kapaciteteve të Shqipërisë për të përmbushur këto nevoja. Asistenca do të planifikohet me koherencë dhe gjithëpërfshirje, që të përmbushen sa më mirë katër objektivat specifike dhe të adresojë prioritetet tematike të renditura në Shtojcën II të Rregullores IPA II, si dhe prioritetet tematike të asistencës për bashkëpunim territorial të renditura në Shtojcën III të së njëjtës Rregullore.

Për më tepër, asistenca e BE-së është vetëm një nga mjetet për të arritur përparimin e nevojshëm. Kur përcaktohen prioritetet për veprim, merren parasysh mirë edhe mjetet e vetë përfituesit dhe mbështetja e dhënë nga instrumentë të tjerë të BE-së dhe nga aktorë të tjerë, në veçanti donatorët dypalësh apo institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë pikëpamje, përparësi i jepet dhënies së asistencës financiare me bazë sektoriale, që të sigurohet përqsasje më afatgjatë, koherente dhe të qëndrueshme, të rritet pronësia, të lehtësohet bashkëpunimi ndërmjet donatorëve, të eliminohet publikimi i përpjekjeve dhe të rritet efienca dhe efektiviteti.

¹ 1 GZ L 77, 15.03.2014, fq. 11.

Me synimin për të realizuar prioritetet e përcaktuara për asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë për shtatë vitet e ardhshme, ky Dokument Strategjik përcakton objektiva kuptimplotë dhe realë, identifikon aksionet dhe aktorët kryesorë, përshkruan rezultatet e pritshme, tregon se si progresi do të matet dhe monitorohen, si dhe përcakton alokimet financiare indikative. Prioritetet e përcaktuara për asistencën financiare do të shërbejnë si bazë për programimin një(shumë)vjeçar të fondeve IPA II nga viti 2014 deri në 2020. Alokimet financiare indikative lejojnë që një sasi e duhur asistence të jetë në dispozicion si "shpërblim" në bazë të vlerësimit të performancës dhe progresit të arritur gjatë periudhës 7-vjeçare, por jo më vonë se përkatësisht viti 2017 dhe 2020, siç përcaktohet në Rregulloren e IPA II.

Ky Dokument Strategjik do të rishikohet në planin afatmesëm dhe do t'i bëhen ndryshimet e përshtatshme. Gjithashtu, mund të rishikohet në çdo moment me nismën e Komisionit Evropian.

2. Konsultimet për këtë Dokument Strategjik

Dokumenti Strategjik është hartuar në bashkëpunim të ngushtë dhe partneritet me Qeverinë shqiptare. Për më tepër, janë zhvilluar konsultime me institucionet përkatëse, si gjyqësori, pushteti vendor, shoqëria civile, institucioneve financiare ndërkombëtare, organizata ndërkombëtare dhe donatorë të tjerë.

Procesi i konsultimit përfshiu një vetëvlerësim nga autoritetet shqiptare duke përdorur kriteret e vlerësimit me bazë sektoriale; pra gjendja e tanishme e politikave sektoriale dhe strategjive, buxhetimi afatmesëm, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi i performancës. Prioritetet relevante për procesin e integritimit në BE janë identifikuar në bazë të progres-raportëve dhe strategjisë së zgjerimit të BE-së. Gjithashtu, është zhvilluar dialog strategjik me Parlamentin Evropian në këtë drejtim. Pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2013, konsultime shtesë u mbajtën me qeverinë e sapoformuar.

PJESA II: ANALIZA E NEVOJAVE DHE KAPACITETEVE

1. Konteksti politik dhe ekonomik

Shqipëria ka një popullsi prej 2.8 milion banorë², sipërfaqe 28,750 km² dhe vijë bregdetare prej 362 km. Kufizohet Greqinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Italinë e Kosovën³. Shqipëria është demokraci parlamentare. Që prej rënies së regjimit komunist në 1991, Shqipëria ka zhvilluar gradualisht kuadrin kushtetues dhe juridik, i cili është përgjithësisht në përputhje me

² Censusi i Popullsisë dhe Banesave për Shqipërinë 2011

³ * Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës

parimet dhe standardet thelbësore evropiane. Pushteti vendor bazohet në parimin e decentralizimit dhe ushtron kompetencat në pajtim me parimin e autonomisë vendore.

Shqipëria ka parlament me një dhomë, i cili është organi më i lartë i shtetit. Presidenti i Republikës zgjidhet nga Parlamenti. Çdo katër vjet, 140 deputetët zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë universal me sistem rajonal proporcional. Zgjedhjet shumëpartiake u mbajtën për herë të parë në vitin 1991. Partia Demokratike (PD), Partisë Socialiste (PS) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) kanë formuar koalicionet qeverisëse gjatë kësaj periudhe. Ka edhe parti të vogla me ndikim të rëndësishëm të cilat kanë qenë pjesë e këtyre koalicioneve. Pas zgjedhjeve të qershor 2013 që i fitoi Aleanca për Shqipërinë Evropiane (një koalicion i përbërë nga PS, LSI dhe disa parti të tjera), u krijua qeveria me kryeministër z. Edi Rama, kryetar i PS dhe me pjesëmarrjen e LSI-së. Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani, u zgjodh në qershor 2012 me një mandat pesëvjeçar.

Polarizimi i jetës politike dhe dobësitë në menaxhimin e sektorit publik cenojnë demokracinë dhe ekonominë e vendit. Administrata publike karakterizohet nga politizimi i lartë dhe rreziku i lartë nga korrupsioni, që pengojnë profesionalizmin, vazhdimësinë dhe efektivitetin. Po ashtu, edhe gjyqësori cenohet po njësoj nga politizimi dhe korrupsioni.

Ekonomia shqiptare ka vazhduar të ketë rritje ekonomike pozitive, por të ulët, gjatë krizës së fundit globale financiare dhe ekonomike. Rritja e PBB-së (Prodhimi i Brendshëm Bruto) u ngadalësua nga 3.3% në vitin 2009 në 1.6% në vitin 2012, krahasuar me rritjen mesatare vjetore prej mbi 6% në periudhën 2003-2008. PBB për frymë aktuale është sa rreth 30% e mesatares së BE-28 (me standardet e fuqisë blerëse - PPS). Raporti i borxhit publik ndaj PBB ishte 64% në vitin 2012 dhe kapërceu 70% në fund të vitit 2013; një ndër raportet më të larta në rajon. Kontribuesit kryesorë në PBB janë bujqësia (22.5%), industria (11.4%), ndërtimi (10.5%) dhe shërbimet (56%).

Shqipëria eksporton kryesisht minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike (40.4%), tekstile dhe këpucë (28.2%) dhe materialet e ndërtimit dhe metalet (14.7%). Partneri kryesor tregtar është BE-ja, me një suficit tradicional në favor të BE-së (2.5 miliard EUR importe nga BE-ja kundrejt 1 miliard EUR eksporte drejt BE-së në vitin 2012). Deficiti persistent i llogarisë korente u tkurr nga 15% në 2008 në 10.9% të PBB-së për shkak të ngadalësimit të rritjes ekonomike gjatë 2012, por mund të rritet sërish deri në 15% në vitin 2016, sipas parashikimeve të FMN-së. Deficiti i lartë strukturor në bilancin e mallrave dhe shërbimeve është shoqëruar tradicionalisht me fluks të lartë hyrës neto të transfertave, por ky fluks ka shënuar trend në rënie vitet e fundit. Vitet e kaluara, Shqipëria ka arritur të tërheqë nivele relativisht të larta të IHD-së që financuan një pjesë të konsiderueshme të deficitit të llogarisë korente.

Performanca e përgjithshme industriale dhe tregtare është karakterizuar me mungesë të konkurrueshmërisë së ekonomisë. Konkurrueshmëria pengohet nga mangësitë në shtetin e së drejtës, përfshi ekzekutimin e kontratave, paqartësitë në titujt e pronësisë, mungesa e një fuqie punëtore të specializuar dhe të aftë, si edhe ekonomie informale e madhe. Sipas Raportit të

Konkurrueshmërisë Globale 2012-2013, Shqipëria renditet në vendin e 89-të ndërmjet 144 vendeve, si dhe në vendin e 123-të për sa i përket novacionit.

Në kushtet e zhvillimit të përgjithshëm social-ekonomik, e matur nga Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (HDI)⁴, vendi paraqitet në kategorinë e 'zhvillimit të lartë njerëzor', renditur i 70 nga 187 vendet dhe territoret në 2012. Shkalla e papunësisë është e lartë dhe me një tendencë në rritje (14% në 2012 dhe rreth 17% në fund të 2013). Ka një përhapje të lartë të papunësisë afat-gjatë dhe dallimeve të mëdha gjinore në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore. Është shqetësuese, më shumë se 30% e të rinjve nuk janë as në punësim as në arsim e as në trajnim.

Rreth 14% e popullsisë vlerësohet se është e cenueshme ndaj varfërisë⁵. Tregu i punës është i shtrembëruar nga sektori informal i gjerë⁶. Potenciali i fuqisë punëtore është shumë i lartë, me mbi 40% të popullsisë në moshë pune, kryesisht femra, janë aktivë. Përqindja e rinisë jashtë sistemit arsimor, formimit profesional dhe punësimit është sa dyfishi i mesatares së BE-27⁷. Mbi treçtereku i të papunëve janë të papunë afatgjatë⁸.

Shqipëria mbetet e angazhuar ndaj politikave antidiskriminim dhe barazisë gjinore, po ekzistojnë shqetësime për zbatimin e trajtimit të barabartë për romët dhe egjiptianët; komunitetin e lesbikeve, gejëve, biseksualëve, transeksualëve dhe ndërseksualëve; si dhe gratë.

Gratë në përgjithësi janë të nënpërfaqësuar në jetën publike dhe diskriminohen për akses në punësim, arsim dhe pronë. Dhuna në familje mbetet shqetësim, pavarësisht progresit të kohëve të fundit.

Shqipëria ka nevojë të konsiderueshme për investime, për shembull në infrastrukturën e transportit, mjedisit dhe energjisë. Për ta ilustruar, në 2011 Shqipëria ka pasur 113 km rrugë dhe 14 km hekurudhë për 100 000 banorë, që janë përkatësisht sa 13.8% dhe 32% e mesatares së BE-27 prej 821 km rrugë dhe 43 km hekurudha për 100 000 banorë. Një tablo e ngjashme ekziston në sektorë të tjerë që kanë nevojë për investime në infrastrukturë. Në veçanti, trajtimi i ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve janë në fazat e hershme të zhvillimit.

Vendi është i ndjeshëm ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, sidomos thatësira dhe përmbytjet, si edhe mungesat e mundshme të energjisë elektrike për shkak të varësisë së lartë ndaj energjisë hidrike që kërkon importe sezonale të energjisë elektrike.

⁴ Burimi: Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP, 2013)

⁵ Burimi: Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT)

⁶ Burimi: INSTAT- Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore, t4 2013

⁷ Burimi: Projekt-strategjia për Punësimin dhe Aftësitë

⁸ Burimi: Progres Raporti i Komisionit European 2013 për Shqipërinë

2. Konteksti për planifikimin e asistencës

2.1 Strategjia e Zgjerimit e BE-së

Në 2003, Këshilli Evropian në Selanik konfirmoi se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor, përfshi Shqipërisë, është në Bashkimin Evropian. Që në 2004, Shqipëria merr pjesë në Procesin e Stabilizim-Asociimit të Ballkanit Perëndimor dhe nënshkroi MSA-në me BE-në në 2006. Shqipëria aplikoi për anëtarësim në BE në vitin 2009. Me kërkesë të Këshillit, Komisioni paraqiti Opinionin e vet mbi aplikimin e Shqipërisë në nëntor 2010.

Nisur nga progresi i bërë nga Shqipëria që nga atëherë, Komisioni rekomandoi në tetor 2013 që Këshilli t'i japë Shqipërisë statusin e vendit kandidat me mirëkuptimin që Shqipëria të vazhdojë të marrë masa në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Për hapjen e negociatave për anëtarësim, Komisioni konstatoi se Shqipëria duhet të përmbushë prioritetet kyçe që kanë të bëjnë me administratën publike dhe reformën e gjyqësorit (me fokus profesionalizmin dhe depolitizimin), luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe përfundimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e pronësisë⁹. Parlamenti Evropian kërkoi që këto prioritete të adresohen dhe të konsolidohet progresi i arritur deri tani¹⁰.

Në qershor 2014, Këshilli Evropian i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat.

Liberalizimi i vizave për qytetarët e Shqipërisë që udhëtojnë në zonën Shengen, është në fuqi që nga dhjetori 2010. Marrëveshja e ripranimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë është në fuqi që nga viti 2005.

Shteti i së drejtës do të qëndrojë në zemër të procesit të zgjerimit. Zbatimi i plotë dhe në kohë i strategjive dhe planeve të veprimit përkatëse në fushën e shtetit të së drejtës dhe të drejtat themelore do të jetë thelbësor në këtë drejtim.

Strategjia e tanishme supozon që Shqipëria do të ruajë angazhimin e saj për ambiciet e integritimit në BE, që do të vazhdojë zbatimin e reformave përkatëse dhe se procesi do të vazhdojë edhe në periudhën 2014-2020, duke përfshirë edhe fillimin e negociatave për anëtarësim sapo vendi të ketë arritur shkallën e nevojshme të pajtueshmërisë me kriteret e anëtarësimit.

Gjendja ekonomike e Shqipërisë kërkon forcimin e qeverisjes ekonomike që të përparohet gradualisht drejt një ekonomie tregu funksionon gradualisht. Në përputhje me Strategjinë e Zgjerimit të Komisionit të tetorit 2013, vendet e zgjerimit përfshi Shqipërinë ftohen që të përmirësojnë politikat ekonomike dhe qeverisjen nëpërmjet përgatitjes së Programeve Kombëtare të Reformave Ekonomike vjetore si edhe Programin e Konkurrueshmërisë dhe Rritjes, që do të dorëzohet çdo dy vjet. Programet Kombëtare të Reformave Ekonomike do të çojë në orientime

⁹ Strategjia e Zgjerimit të BE-së dhe Sfidat Kryesore 2013-2014

¹⁰ Rezoluta e Parlamentit Evropian (2013) mbi progres raportin për Shqipërinë, 2013/2879(RSP)

sipas secilit vend për të arritur progres gradual në përmbushjen e kriterëve ekonomike të anëtarësimit. Një pjesë integrale e strategjisë së zgjerimit të BE-së në lidhje me Shqipërinë është menaxhimi financiar publike (shih më poshtë në Pjesën IV, seksioni 1).

2.2. Strategjitë kombëtare/rajonale relevante

Qeveria e Shqipërisë po përgatit projektin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014-2020. SKZHI përbën kornizën strategjike për të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale dhe është shtylla kurrizore e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) - një grup parimesh operative që siguron planifikim dhe ndërlidhje efikase të politikave, buxhetimit dhe monitorimit të qeverisë. SKZHI orienton Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe alokimet e buxhetit vjetor, duke siguruar objektivat e politikave që janë të përfshira në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit nga të gjitha ministrinë dhe agjencitë.

Pas krijimit të qeverisë së re në vitin 2013, filloi një proces i ri dhe gjithëpërfshirës për zhvillimin e prioritetëve të politikave të Qeverisë. Ky proces përfshinte identifikimin e objektivave prioritare, kryerjen e vlerësimeve me indikatorë të mirëpërcaktuar, si dhe përgatitjen e udhërrëfyesve dhe planeve konkrete për t'u zbatuar nga ministrinë e linjës përkatëse. "Njësia e Jetësimit të Prioritetëve pranë Kryeministrisë zbaton dhe monitoron procesin. Kështu, do të hartohet SKZHI dhe strategjitë sektoriale, si edhe strategjia kombëtare për integrimin evropian, dhe pritet të finalizohen para fundit të vitit 2014. Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI) siguron koordinimin strategjik.

Planet kombëtare të Shqipërisë janë parashikuar të jenë në një linjë me disa nisma rajonale integruese. Kjo përfshin angazhimin për të realizuar objektivat e rritjes rajonale të Evropës Juglindore (SEE) 2020. Për më tepër, Shqipëria merr pjesë në Strategjinë e re të BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) që synon të promovojë begatinë ekonomike e sociale dhe rritjen në rajon, duke mbështetur rritjen "blu", përmirësimin e ndërlidhjeve të rrjeteve të transportit / energjike, cilësi më të mirë mjedisit dhe masa për turizëm të qëndrueshëm. Strategjia përmban edhe aspekte ndërsektoriale si forcimi i kapaciteteve, komunikimi, hulumtimi, novacioni dhe NVM-të.

Për më tepër, Shqipëria bashkëpunon në zhvillimin e një rrjeti rajonal transporti në përputhje me planin shumëvjeçar të Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO). Shqipëria ka nënshkruar Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) që përgatit politikën tregtare të vendit për të përmbushur standardet e anëtarësimit në BE. Së fundi, Shqipëria merr pjesë në Rrjetin e Pranimet Rajonal për Klimën (ECRAN) dhe në Grupin e Përhershëm për Zhvillimin Rural që nxisin bashkëpunimin rajonal në zbatimin e politikave mjedisore dhe bujqësore.

2.3 Kushtet për menaxhimin e asistencës së para-anëtarësimit

Kur gjykojmë për aftësinë e përgjithshme të Shqipërisë për të menaxhuar fonde në pajtim me legjislacionin dhe praktikën më të mira të BE-së, duhet të marrim parasysh këta elementë:

Përqasja sektoriale

Përqasja sektoriale funksionale kërkon strategji dhe politika qeveritare, kuadër buxhetore afatmesme, koordinim, monitorim rezultatesh dhe vlerësim performancash. Shqipëria është në pozita të mira për të përmbushur këto kritere, pasi po harton SKZHI 2014-2020 dhe strategjitë sektoriale përkatëse. Strategjitë do të shoqërohen me një Plan Buxhetor Afatmesëm (PBA) që parashtron kuadrin financiar që udhëheq zbatimin e reformave sektoriale. Koordinatorin e donatorëve është siguruar me grupe pune sektoriale të koordinuar direkt nga zv.Kryeministri (shih seksionin 2.4 më poshtë). Monitorimi dhe vlerësimet e performancës po përmirësohen me përpjekjet për të forcuar monitorimin dhe veprimtarinë e grupeve të punës, ku do të mbahen parasysh dialogu për performancën dhe arritjet në sektorët respektivë.

Menaxhimi indirekt i fondeve

Parimisht, kushtet janë plotësuar për *menaxhimin indirekt* (më parë ishte sistemi i zbatimit të *decentralizuar*); në vitin 2014, Komisioni miratoi vendimin për t'ua kaluar autoriteteve shqiptare menaxhimin e fondeve IPA për komponentin I të IPA I. Ky akreditim për IPA I pritet të jetë baza e menaxhimit *indirekt* të programeve respektive të financuara prej IPA II.

Kontratat e reformës sektoriale (mbështetja buxhetore sektoriale)

Shqipëria përfiton mbështetje buxhetore sektoriale nëse përmbush këto katër parakushte: kuadër makroekonomik stabil; program të besueshëm dhe relevant për të përmirësuar menaxhimin financiar publik; transparencë dhe mbikëqyrje e buxhetit; strategji sektoriale të besueshme dhe relevante në konsistencë me strategjinë e aderimit në BE.

Shqipëria është në pozita të mira për të përmbushur këto katër parakushte për këto arsye:

1. Situata makroekonomike është përgjithësisht stabil dhe është përmirësuar vitet e fundit;
2. Për menaxhimin financiar publik, në fund të 2014 pritet të përfundojë përgatitja e një programi të besueshëm reformash;
3. Për transparencën e buxhetit, plani buxhetor afatmesëm është pjesë e dokumentacionit të dorëzuar në Parlament që garanton mbikëqyrje të buxhetit; legjislacioni mbi funksionimin e KLSH-së pritet të ndryshohet nga mesi i vitit 2014;
4. Politikat dhe strategjitë janë ose të miratuara, ose po hartohen në përputhje me zhvillimin e SKZHI-së të përmendur më lart në seksionin 2.2.

Me gjithë përparimin e bërë deri tani, nevojitet konsolidim dhe përmirësim i mëtejshëm. Sidomos, duhet të forcohet rritja ekonomike dhe të ulet borxhi publik. Për sa i përket menaxhimit financiar publik, duhet të përmirësohen parashikimet për të ardhurat, kontrollet e brendshme dhe menaxhimi i shpenzimeve. Shqipëria është e përkushtuar dhe ka filluar adresimin e çështjeve të ngelura pezull në kuadrin e marrëveshjeve përkatëse me FMN-në dhe Bankën Botërore në fillim të vitit 2014.

2.4 Koordinimi i donatorëve dhe komplimentariteti me asistencat e tjera të BE-së

Shqipëria angazhohet që të integrojë asistencën IPA II në planet zhvillimore kombëtare dhe të koordinojë mirë kuadrin buxhetor afatmesëm me asistencën e siguruar prej të tjerëve. Përpjekjet e

Shqipërisë për zhvillim dhe integrim në BE mbështeten nga mbi 40 donatorë dypalësh dhe shumëpalësh¹¹.

Ky koordinim i donatorëve është nën përgjegjësinë e Kryeministrit me mbështetjen e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhimës së Huaj (DPZHFNH) pranë Kryeministrit. Siç u tha në seksionin 2.2, kuadri strategjik sigurohet nga SKZHI. Zbatimi i planeve strategjike do të bëhet përmes programeve buxhetore afatmesme që përmbajnë parashikime për burime financimi të brendshme dhe donatore që do të mbështetin zbatimin e strategjive. Koordinimi i fondeve të donatorëve parashikohet në sistemet e planifikimit strategjik dhe në programet buxhetore përkatëse.

Koordinimi i përgjithshëm brenda qeverisë shqiptare përfshin një Komitet Planifikimi Strategjik si komitet ndërministror i kryesuar nga Kryeministri, që shqyrton dhe miraton politikat dhe prioritetet fiskale të qeverisë. Ky rol përfshin (i) përcaktimin e prioriteteve të politikave dhe drejtimet strategjike brenda kuadrit të shëndoshë fiskal, në fillim të procesit të planifikimit vjetor; (ii) vendimmarrjen për alokimin e burimeve ndërsektoriale (tavanet e përgatitjes së PBA-së) në planin afatmesëm, pra 3 vjeçar; (iii) shqyrtimin e projekt PBA-së para përgatitjes së buxhetit shtetëror; dhe (iv) marrjen e raporteve periodike mbi progresin e bërë në realizimin e angazhimeve kryesore të SPI-së.

Për të siguruar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet ministrive të linjës për sektorë specifikë, janë ngritur disa grupe pune ndërministrorë (GNP). Koordinimi i aktiviteteve nga DPZHFNH-së përfshin mbajtjen e një databaze projektesh, koordinimin e takimeve të komunitetit të donatorëve ndërkombëtarë, të Grupeve të Punëve Sektoriale (GPS), si edhe nxjerrjen e një buletini mujor për dialogun me qeverinë. Një herë në vit zhvillohet një dialog i nivelit të lartë donatorë-qeveri, si “tryezë e rrumbullakët” që fokusohet në harmonizimin e ndihmës, i pasuar me takime operacione periodike. Kjo punë mbështetet nga Sekretariati Teknik i Donatorëve (STD), i përbërë nga katër organizata shumëpalëshe donatore, përfshi BE-në dhe pjesëmarrjen me rotacion të dy donatorëve dypalësh. GPS-të po mbështetin koordinimin në nivel sektorial; ato përbëhen nga qeveria, përfaqësues të donatorëve dhe aktorë të tjerë sipas nevojës. 33 grupet e parashikuara shkëmbejnë informacion me fokus koordinimin e politikave, priorizimin e ndihmës dhe monitorimin e zbatimit.

Përveç koordinimit nga qeveria e Shqipërisë, BE-ja konsultohet rregullisht me donatorët e tjerë, shoqërinë civile dhe të tjerët (p.sh. gjyqësorin), si gjatë përgatitjes së përfaqësues strategjike, ashtu edhe gjatë përgatitjes së programeve vjetore.

2.5 Konsistenca me politikat e BE-së

Asistenca financiare e identifikuar në këtë Dokument Strategjik do të jepet në pajtim me dhe në mbështetje të strategjisë së zgjerimit të BE-së për Shqipërinë. Asistenca do të konturohet në konsistencë me politikat e BE-së relevante për sektorët respektivë, sidomos me strategjitë *Europe 2020*, *EUSAIR* dhe *SEE 2020*, si nisma pararojë të BE-së për të nxitur rritjen ekonomike dhe punësimin, për të promovuar nismat për rritje të zgjuar, përfshirëse dhe të qëndrueshme, si edhe objektivat e politikave të BE-së për klimën. Objektivat e përcaktuar për periudhën deri në vitin 2020 pasqyrojnë nivelin e zhvillimit ekonomik dhe nivelin e gatishmërisë së Shqipërisë në procesin e aderimit.

¹¹ Shih: http://dsdc.gov.al/dsdc/Donor_Database_33_2.php

PJESA III: SKEMA E ASISTENCËS SË PARA-ANËTARËSIMIT PËR SHQIPËRINË

Shqipëria ka të miratuara politika dhe strategji për reformat dhe investimet që ia lehtësojnë procesin e anëtarësimit në BE. Ndhima financiare e BE-së do të ndihmojë për avancimin e reformave dhe lehtësimin e investimeve relevante për procesin e anëtarësimit, si edhe kontribuon në zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë. Është e qartë që reformat institucionale dhe legjislative, si dhe investimet në zhvillimin e infrastrukturës, kërkojnë burime shumë më të mëdha sesa buxheti kombëtar i Shqipërisë, i IPA-s, apo mbështetje që mund të ofrojnë donatorë të tjerë. Priorizimi i punës është thelbësor; në këtë aspekt, strategjia e fundit e zgjerimit të BE-së për 2013-2014 njih nevojën për të hedhur "bazat fillimisht". Nisur nga vlerësimi i nevojave të vetë Shqipërisë dhe nga konstatimet e Komisionit, është vendosur që ndihma e para-anëtarësimit për periudhën 2014-2020 të fokusohet mbi qeverisjen, shtetin e së drejtës, konkurrencën dhe rritjen ekonomike.

Qeverisja dhe shteti i së drejtës

Qeverisja dhe shteti i së drejtës janë evidentuar në progres raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, si edhe në konkluzionet e Këshillit, si sfida kryesore që Shqipëria do të duhet të adresojë në rrugën drejt anëtarësimit. Lidhur me **demokracinë dhe qeverisjen**, duhen forcuar më shumë institucionet demokratike, sidomos roli i parlamentit për ndërtimin e konsensusit kombëtar. Një çështje kyçe që duhet adresuar është administrata publike, përfshi **reformën në administratën publike** (RAP) dhe koordinimin, politikëbërjen dhe shërbimin civil, si dhe organizimin e administratës publike dhe funksionimin në nivel qendror e civil. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për depolitizimin e shërbimit publik, që të sigurohet vazhdimësia, të promovohen standardet etike në administratë, të forcohet meritokracia në emërimet, ngritje në detyrë dhe largime nga puna, si edhe të rritet efikasiteti dhe qëndrueshmëria financiare. Një administratë publike e shëndetshme dhe funksionale në nivel qendror dhe vendor është parakusht për përparimin në mjaft sektorë të tjerë, si dhe thelbësore për rritje të investimeve, qofshin të huaja apo të brendshme. Nevojiten masat specifike në lidhje me gjyqësorin për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të nxitur rritjen ekonomike.

Për shkak të borxhit publik të lartë (mbi 70% e PBB-së në fund të 2013-ës), Shqipëria ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme në reformimin e sistemit të vet të **menaxhimit financiar publik** (MFP). Mbështetje do të jepet për zbatimin me faza të një programi shumëvjeçar për MFP (përfshi një strategji dhe plan veprimi), që mbulon mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, përgatitjen e buxhetit, ekzekutimin e buxhetit me menaxhimin e parasë, menaxhimin e borxhit, prokurimin publik, kontabilitetin dhe raportimin, kontrollin e brendshëm financiar publik dhe auditin e jashtëm. Mbështetja për MFP do të jetë nismë e përbashkët me institucionet e tjera ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore, që kanë nisur tashmë masat mbështetëse në fillim të 2014. Përmirësimet në sistemin MFP do të sigurojnë një bazë të qëndrueshme për programet e qeverisjes ekonomike. Për më tepër, sistemet e statistikave kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme në mënyrë që të jenë sa më të harmonizuara me standardet e BE-së.

Shoqëria civile ka nevojë të forcohet më tej, përfshi forcimin e kapaciteteve dhe nxitjen e krijimit të një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e tij dhe përfshirjen më të madhe të grupeve të interesit në reforma, përmes edhe transparencës më të madhe të veprimeve dhe shpenzimeve shtetërore.

Konkluzionet e Këshillit 2013 nënvizojnë nevojën për të intensifikuar përpjekjet në fushën e shtetit të së drejtës. Për më tepër, strategjia e zgjerimit e BE-së e evidenton shtetin e të drejtës si “zemra e procesit të zgjerimit”. Për këtë arsye, BE-ja do të mbështesë reformat në fushën e **shtetit të së drejtës dhe të drejtat themelore**. Brenda kësaj fushe, rekomandimet e Komisionit të Venecias të KiE do të përbëjnë kuadrin për mbështetjen që do t’i jepet sistemit të drejtësisë në të ardhmen. Prioritet kyç në këtë drejtim është lufta kundër korrupsionit, sidomos brenda institucioneve të gjyqësorit. **Të drejtat themelore** të minoriteteve dhe grupeve sociale vulnerabil, - përfshi romët, egjiptianët dhe fëmijët – kërkojnë mbështetjen e BE-së për përmirësimin e tyre. Përpjekjet e qeverisë shqiptare për ngritjen e një kuadri të qartë për të drejtat e pronësisë meritojnë asistencë IPA II, nisur nga impakti i gjerë që kanë të drejtat e pronës mbi çështje si tregjet e tokës dhe kreditimit, zhvillimi i infrastrukturës dhe të tjera. Përpjekjet për të forcuar **sundimin e ligjit** kanë nevojë për mbështetje të qenësishme dhe konsistente, sidomos në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parasë, trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafikut të drogës.

Konkurrueshmëria dhe rritja

Kriza ekonomike globale ka theksuar nevojën që Shqipëria të forcojë qeverisjen ekonomike, në veçanti politikat ndaj konkurrueshmërisë dhe rritjes ekonomike. Për këtë, nevojitet mbështetje në këto fusha:

Në fushën e **mjedisit dhe masave për klimën, të transportit**, si dhe të **energjisë**, Shqipëria duhet të forcojë më tej kapacitetet e menaxhimit, në mënyrë që të përgatisë dhe zbatojë politika që janë në përputhje me legjislacionin dhe praktikën më të mira të BE-së. Veç kësaj, nevojat e financimit për investime janë të mëdha: në lidhje me **mjedisin**, për shembull, është llogaritur që në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së, vetëm në sektorin e ujit Shqipërisë do t’i duhen mbi 2 miliardë Euro investime; nevojat shtesë për infrastrukturën janë vlerësuar gjithashtu të kushtojnë më shumë se disa qindra milionë Euro. Për shkak të disponueshmërisë së kufizuar të burimeve financiare dhe meqë qëndrueshmëria e investimeve në këto fusha deri më tani nuk ka qenë plotësisht e kënaqshme, asistencë IPA II do të parashikojë zhvillimin e kapaciteteve të administratës shqiptare për të vepruar dhe mbështetur investimet që lidhen me të, para se të marrë në konsideratë investimet e reja. Për sa i përket **transportit**, prioritetet janë për të garantuar plotësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të plotë të infrastrukturës ekzistuese hartuar nga Observatori i Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) (si Korridori VIII), lidhjen me rrjetin e transportit trans-evropian, si dhe për të adresuar çështjet e sigurisë në të gjitha llojet e transportit.

Në lidhje me **energjinë**, nevojiten reforma për të siguruar funksionimin normal të sistemit në tërësi, si dhe qeverisjen e mirë të sektorit. Financimi për prodhimin e energjisë është zakonisht fitimprurës dhe mund të financohet nga institucionet financiare. Gjithashtu, do të parashikohet mbështetje për forcimin e kapaciteteve administrative, përafrimin me legjislacionin e BE-së, si dhe përpjekje të veçanta të nevojshme për të zgjidhur problemet në lidhje me borxhet e akumuluar, humbjet dhe vjedhjet, si dhe normat e ulëta të arkëtimit.

Masat ose aksioni për klimën paraqet një element ndër-sektorial që vlen për shumicën e fushave në Dokumentin Strategjik, sidomos në fushat e transportit, energjisë, bujqësisë dhe zhvillimit

rural, si dhe menaxhimin e katastrofave. Shpenzimet relevante të masave për klimën do të përcillen në të gjithë gamën e ndërhyrjeve të IPA II në Shqipëri, në përputhje me treguesit statistikorë të Komisionit të Asistencës për Zhvillimin (DAC-OECD) për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen.

Nivelet e ulëta të prodhimit dhe konkurrueshmërisë, si dhe kushtet e jetesës në zonat rurale kërkojnë mbështetje për **zhvillimin rural dhe bujqësinë**. Për këtë kërkohet përgatitje e strukturave administrative të afta për të ofruar shërbime dhe për të menaxhuar fondet në përputhje me politikat bujqësore të BE-së. Mbështetja e IPA II nevojitet për krijimin e një sektori agro-ushqimor konkurrues dhe novator, efikas dhe të qëndrueshëm, i aftë për të përballuar presionin konkurrues në tregjet e brendshme dhe ato të BE-së, që ofron punësim, përfshirjen sociale dhe standardet më të mira të jetesës për fermerët dhe popullsinë rurale. Zbatimi i shëndoshë i masave mbështetëse për bujqësinë, që forcojnë aksesin e biznesit në informacion dhe tregje; siguria ushqimore, shërbimet veterinarë dhe fitosanitare, dhe kontrollet, që funksionojnë në përputhje me direktivat e BE-së, kërkojnë asistencën e IPA II me vëmendje të veçantë në tregjet e mundshme të eksportit. Përveç kësaj, financimi IPA II nevojitet për të ndihmuar në përmirësimin e nën-sektorit të peshkimit.

Rritja ekonomike duhet forcuar për të nxitur **konkurrencën dhe inovacionin**, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të novacionit në përgjithësi dhe në veçanti nëpërmjet zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Duhet të rritet integrimi i Shqipërisë në tregjet rajonale dhe ato të BE-së, si dhe kontributi i eksporteve në zhvillimin e vendit. Nevojitet financimi i IPA II për të adresuar këto nevoja duke mbështetur aksesin dhe kërkesën për shërbimet e zhvillimit të biznesit, aksesin në financa për NVM-të, integrimin e tregut, dhe duke zhvilluar më tej tregjet e eksportit, përfshi tregjet e paeksploruar dhe turizmin. Në këtë kontekst, IPA II mund të parashikojë asistencë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Për sa i përket **arsimit, punësimit dhe politikave sociale**, kërkohet mbështetje e barabartë sidomos për arritjen e gjithëpërfshirjes. Përveç punësimit informal dhe pjesëmarrjes së ulët, është e nevojshme të vendosen qartë sfidat e tregut të punës dhe të përcaktohen kapacitetet e duhura në përputhje me rrethanat. Shqipëria duhet të përmirësojë cilësinë dhe rëndësinë e të gjitha niveleve të arsimit dhe të zhvillojë bazën e saj të aftësive në përputhje me nevojat e tregut të punës. Duhet të përmirësohen shanset e hyrjes në tregun e punës për gratë dhe grupet e pafavorizuara. Qeverisja e mirë e kësaj fushe duhet forcuar. Së fundi, konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore kërkon asistencë në fushën e **bashkëpunimit territorial dhe bashkëpunimit rajonal**.

Përveç kësaj, mbështetja IPA mund të jepet gjithashtu për nevojat prioritare të paparashikuara, relevante gjatë negociatave për anëtarësim, të cilat nuk përfshihen në këto fusha. Në veçanti, kjo mund të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në asistencën teknike *ad hoc* dhe afat-shkurtër që mbështetet në kuadër të instrumentit TAIEX dhe binjakëzimit. Veç kësaj, IPA II mund të vazhdojë të bashkë-financojë kontributin financiar të Shqipërisë për pjesëmarrjen e saj në programet dhe agjencitë e BE-së në kontekstin e vijimit të dialogut politik sipas fushës dhe kapitujve përkatës të negociatave të anëtarësimit.

Së fundi, gjatë programimit të asistencës në kuadër të IPA II, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet çështjeve ndër-sektoriale që ndikojnë në më shumë se një fushë dhe për këtë arsye nevojitet të ndërmerren masa në një numër sektorësh. Këto përfshijnë parandalimin dhe luftën

kundër korrupsionit, qëndrueshmërinë e mjedisit dhe masat për klimën, barazinë gjinore, forcimin e demokracisë, të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile, si edhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Si rrjedhojë e prioriteteve të përcaktuara në këtë Dokument Strategjik, alokimi indikativ financiar sipas fushave dhe sektorit është paraqitur në Shtojcën 1.

PJESA IV: ASISTENCA E BE-së PËR PERIUDHËN 2014-2020

1. Demokracia dhe qeverisja

1.1. Nevojat dhe kapacitetet

Me synimin për të sqaruar qëllimin e kësaj fushe, duhet theksuar se kjo fushë përfshin institucionet demokratike dhe menaxhimin e përgjithshëm të sektorit publik, përfshi koordinimin e reformës së administratës publike (RAP), politikëbërjen, shërbimin civil dhe administratën publike në nivel qendror dhe vendor; menaxhimin financiar publik (MFP), përfshi realizimin e të ardhurave dhe administratën, përgatitjen e buxhetit, ekzekutimin e buxhetit me menaxhim *cash*, prokurimin publik, kontabilitetin dhe raportimin, menaxhimin e borxhit, kontrollin e brendshëm financiar publik dhe auditin e jashtëm. Gjithashtu, mbështetje do të jepet për përmirësimin e sistemit të IT dhe ndërveprimin e administratave doganore e tatimore me sistemet e BE-së. Veç kësaj, fusha përfshin mbështetje për statistikën dhe zhvillimin e politikave të bazuara në dëshmi dhe kapacitetet për miratimin në mënyrë progresive të legjislacionit përkatës të BE-së. Së fundi, zhvillimi i shoqërisë civile është pjesë e kësaj fushe. Lufta kundër korrupsionit është një element i rëndësishëm i performancës së sektorit publik dhe përfshihet për më tepër në fushën 'Drejtësia dhe të drejtat themelore'.

Asistenca e mëparshme e IPA-s është dhënë për RAP, veçanërisht për forcimin e kapaciteteve në një numër fushash të rëndësishme të tilla si MFP, përfshi administratën tatimore dhe doganore, prokurimin publik, auditin e jashtëm, dhe statistikën nëpërmjet ndërhyrjeve të posaçme të ekspertizës teknike. Mbështetja e BE-së gjatë periudhës 2007-13 llogaritet në më shumë se 75 milionë Euro. Në aspektin e aktiviteteve të donatorëve të tjerë, Suedia mbështet reformat e financave publike dhe statistikave; Austria mbështet reformat e menaxhimit financiar publik, përfshi çështjet e politikave tatimore dhe buxhetimin gjinor; veç kësaj Austria dhe Zvicra mbështesin çështjet e decentralizimit; Gjermania mbështet reformën e shërbimit publik. Sistemi i Integritetit të Planifikuar po zbatohet me asistencën e Bankës Botërore dhe me financimin nga BE, si edhe nga Austria, Suedia dhe Zvicra. Si FMN dhe Banka Botërore janë duke mbështetur reformat në MFP, duke u fokusuar në zvogëlimin afatgjatë të borxhit publik.

Kjo fushë ende karakterizohet nga nevoja për përmirësim në ndërtimin e konsensusit demokratik, një shkallë e ulët e burimeve njerëzore në dispozicion, shkallë e lartë e politizimit dhe, në përgjithësi, nga një zbatim i pamjaftueshëm i kuadrit ligjor. Mekanizmat e performancës në bazë të monitorimit duhet të forcohen, ndërsa mekanizmat e vlerësimit të ndikimit duhet të krijohen, për të siguruar zbatimin e politikave të shëndosha, si dhe në fakte të bazuara në politikë-bërje. Këto çështje pritet të adresohen në një strategji të përgjithshme RAP e cila është duke u zhvilluar.

Qeverisja ekonomike dhe MFP kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme, veçanërisht për shkak të nivelit të lartë të **borxhit publik**. Identifikohet nevoja për një reformë të MFP; një program gjithëpërfshirës për MFP është duke u zhvilluar (*shih pjesën II, seksionin 2.3*). Duhet të adresohen gjithashtu pengesat strukturore të rritjes, përfshi mjedisin gjyqësor dhe ligjor. Fusha të veçanta, të tilla si **statistikat**, janë jetike për vendimmarrjen e politikave. Menaxhimi i sektorëve të veçantë si **energjia** duhet forcuar. Organizatat e **shoqërisë civile** dhe media nuk janë duke mbështetur sa duhet kulturën politike demokratike që lejon qytetarët të marrin pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes nëpërmjet informimit. Veç kësaj, organizatat e shoqërisë civile janë tepër të varura nga financimet nga donatorët e huaj. Aktorët dhe organizatat e shoqërisë civile mund të japin kontribut më të rëndësishëm në adresimin e shumë prej këtyre sfidave nëpërmjet lobimit, mbrojtjes dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, në çdo fushë. Ata mund të bëjnë kërkesën për rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit nga institucionet publike dhe të përqendrohen më tepër në nevojat e qytetarëve për hartimin e politikave.

1.2. Objektivat, rezultatet, masat dhe indikatorët

Lidhur me adresimin e sfidave të përmendura më lart, **objektivi** i asistencës së ardhshme IPA II është forcimi i institucioneve demokratike, mbështetja e procesit të reformës së administratës publike dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimit publik për përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane. Një objektiv tjetër është përmirësimi i qeverisjes ekonomike dhe mbështetja për zbatimin e një reforme gjithëpërfshirëse të menaxhimit financiar publik. Mbështetja për shoqërinë civile synon thellimin e mëtejshëm të kulturës demokratike në vend nëpërmjet krijimit të një mjedisi të përshtatshëm dhe forcimit të kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm.

Rezultatet e pritshme që do të arrihen me asistencën e BE-së janë:

- Forcimi i institucioneve demokratike në përputhje me kuadrin ligjor dhe garantimi për ndërtimin e konsensusit për të mbështetur reformat e BE-së;
- Funkionimi i një shërbimi civil të depolitizuar dhe të menaxhuar në bazë merite me sistemet e integritetit dhe standardet etike;
- Përcaktimi plotësisht i shërbimit civil dhe organizimit të administratës publike, koordinimi, dhe funksionimi, përfshi kompetencat dhe përgjegjësinë e qeverisjes vendore për rritjen e kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset;
- Përmirësimi i parashikueshmërisë ligjore dhe zbatimi i ligjeve dhe vendimeve gjyqësore në interes të bizneseve dhe qytetarëve;
- Përmirësimi i stabilitetit fiskal, përfshi qëndrueshmërinë e borxhit publik;
- Menaxhimi i financave publike në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme, pas zbatimit në vazhdimësi të një programi reforme për menaxhimin financiar publik që mbulon mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, përgatitjen e buxhetit, ekzekutimin e buxhetit me menaxhimin e parasë, prokurimin publik, kontabilitetin dhe raportimin, menaxhimin e borxhit, kontrollin e brendshëm financiar publik dhe auditin e jashtëm;
- Përmirësimi i sistemit të IT dhe ndërveprimi i administratave tatimore dhe doganore me sistemet e BE-së;
- Funkionimi i administratave tatimore dhe doganore në përputhje me rregullat e BE-së për të garantuar një sistem efikas në luftën kundër korrupsionit;

- Përmirësimi i mbikëqyrjes së tregut, duke u fokusuar sidomos në sigurinë e produktit me synim mbrojtjen e konsumatorit;
- Proceset e vendimmarrjes ndjekin monitorimin e performancës bazuar në cilësinë e të dhënave statistikore të mbledhura dhe të analizuara në përputhje me standardet e EUROSTAT-it;
- Funkionimi i kapaciteteve të mjaftueshme për menaxhimin e procesit të anëtarësimit në BE, përfshi zhvillimin e politikave, si dhe përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit të përshtatshëm;
- Forcimi i rolit të shoqërisë civile në proceset demokratike dhe rritja e pavarësisë së shoqërisë civile nga fondet e donatorëve të huaj.

Indikatorët për matjen e rezultateve të pritshme janë (*shih listën e plotë të indikatorëve në Shtojcën 2*):

- Përparimi i bërë për plotësimin e kriterëve të anëtarësimit (KE);
- Indikator i përbërë (Efektiviteti i Qeverisë (BB), Barra e Rregullimit Shtetëror (Forumi Ekonomik Botëror (FEB) dhe Cilësia Rregullatore (BB);
- Totali i detyrimeve shtetërore ndaj biznesit (Studim i Deloitte);
- Përputhshmëria statistikore (Eurostat).

Lidhur me **masën** që do të mbështetet, asistenca e BE-së do të përfshijë asistencën teknike dhe ngritjen e kapaciteteve për **reformën e administratës publike** dhe të **institucioneve demokratike**, përfshi parlamentin dhe institucionet e ndryshme të pavarura.

Për sa i përket **qeverisjes ekonomike**, sfidat që lidhen me stabilitetin makroekonomik dhe përparimin të nevojshëm për të kaluar gradualisht në një ekonomi tregu funksionale do të trajtohen nëpërmjet mbikëqyrjes ekzistuese dypalëshe dhe **udhëzuesit të politikave** të veçanta të vendit. Zbatimi i udhëzuesit të politikave do të jetë subjekt i një cikli vjetor inventaresh, i cili do të identifikojë qartë boshllëqet që do të duhet të adresohen për të bërë përparim të mëtejshëm drejt përmbushjes së kriterëve ekonomike të anëtarësimit. Bazuar në këtë udhëzues të politikave, do të përgatiten masa vjetore shoqëruese në bashkëpunim me ofruesit e asistencës teknike, në veçanti përmes FMN. Zbatimi i një programi reforme për menaxhimin financiar publik do të mbështetet në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në dhe Bankën Botërore, në përputhje me veprimet e tyre të kreditimit tashmë në vazhdim dhe do të përfshijë asistencë teknike për të menaxhuar përpjekjet për reforma.

Në fushën e **statistikave**, është parashikuar bashkëpunimi i ngushtë me Eurostat-in për të garantuar pajtueshmërinë me metodologjinë e BE-së, si dhe asistencën për ngritjen e kapaciteteve dhe anketat. Do të mbështetet forcimi i mëtejshëm i administratave **tatimore dhe doganore**, në veçanti për forcimin dhe zbatimin e legjislacionit, përmirësimi i sistemit të IT dhe ndërveprimi me sistemet e BE-së. Nevojat specifike shtesë për ngritjen e kapaciteteve dhe asistencë tjetër teknike për administrimin e fushave të tjera (p.sh. të energjisë) do të konsiderohen për mbështetje.

Zhvillimi i qendrueshëm i **organizatave të shoqërisë civile** (OSHC) dhe lirisë së mediave do të mbështetet me asistencë teknike. Mbështetja për të mundësuar mjedisin dhe ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile do të jepet në përputhje me 'Udhëzimet e veçanta të BE-së' për zhvillimin e shoqërisë civile në rajonin e zgjerimit. Instrumenti i shoqërisë civile do t'i kombinojë të dy fondet si multi-programimin IPA II dhe atë kombëtar për t'iu përgjigjur llojeve të ndryshme të OSHC-ve, nevojave dhe kontekstit të fushës me një qasje fleksibël, transparente dhe ekonomike.

Lidhur me kushtet për **mbështetjen e fushave**, siç është përmendur në Pjesën II, seksioni 2.2, aktualisht janë në zhvillim e sipër disa strategji sektoriale të cilat përfshijnë p.sh. reforma e përgjithshme e administratës publike (Strategjia RAP), por më konkretisht menaxhimi financiar publik, statistikave dhe të tjera. Strategjia për Sistemin e Planifikimit të Integruar për 2005- 2015 është miratuar dhe mbulon modernizimin e politikë-bërjes, proceset e planifikimit të buxhetit dhe kapacitetet në nivelin qendror. Gjithashtu, është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë plani 5-vjeçar i statistikave kombëtare për 2012-2016. Në përgjithësi, ka mungesë të mekanizmave të vlerësimit të ndikimit, si dhe të vlerësimeve të vazhdueshme të monitorimit dhe të performancës. Nevojat specifike në fushën e menaxhimit të financave publike do të mbështeten përmes një përfaqse sektoriale në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në dhe Bankën Botërore nën drejtimin e Ministrisë së Financave.

1.3 Llojet e financimit

Asistenca do të jepet kryesisht përmes binjakëzimit, asistencës teknike, furnizimit me pajisje dhe mundësisht edhe nëpërmjet thirrjeve për propozime dhe granteve të drejtpërdrejta tek autoritetet relevante kombëtare. **Mbështetja e buxhetit të fushës** do të merret në konsideratë për të mbështetur MFP dhe ndoshta elemente të tjera të reformave RAP, me kusht që Shqipëria t'i plotësojë kushtet për mbështetjen e buxhetit të fushës.

Mbështetja shtesë për reformën RAP do të sigurohet nga multi-programimi IPA II nëpërmjet bashkëpunimit me SIGMA-n (OECD) dhe Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ShRAP). Qeverisja ekonomike do të mbështetet gjithashtu në kuadrin e multi-programimit nëpërmjet bashkëpunimit me FMN-në. Në fushën e statistikave, Eurostat do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për zyrat kombëtare të statistikave në kuadër të multi-programimit IPA II. Në fushën e administratës doganore dhe tregtisë rajonale, bashkëpunimi me Sekretariatit e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) do të mbështetet përmes programeve me shumë-përfitues. IPA II mund të bashkëfinancojë kontributin e Shqipërisë për pjesëmarrjen e saj në programet relevante të BE-së; detajet do të vendosen në kohën e programimit.

1.4 Risqet

Risqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave dhe rezultateve të synuara janë:

- a) Situata makroekonomike mund të kufizojë përmirësimet në shpërblime, punësim dhe reformën MFP;
- b) Politizimi i shoqërisë civile dhe mediave zvogëlon rolin e tyre të mundshëm për forcimin e kulturës demokratike.

Lidhur me masat e mundshme për zvogëlimin e riskut, është e rëndësishme të forcohen (i) kapacitetet e autoriteteve shqiptare për të monitoruar progresin e reformës dhe për të marrë masa korigjuese, dhe (ii) përfshirja e monitorimit të pavarur për rekomandimin e masave korigjuese që duhet të ndërmerren. Në lidhje me risqet e identifikuar më sipër, një rol të rëndësishëm janë duke luajtur si programet e reformës ekonomike kombëtare (*shih më lart në pjesën 2*) ashtu dhe dialogu politik për administratën publike (*shih prioritetet kyçe për procesin e anëtarësimit, më sipër seksioni 2.1*). Në fushën e MFP-së, mbështetja buxhetore e BE-së do të adresojë drejtpërdrejt riskun lidhur me borxhin publik dhe reformat MFP.

2. Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore

2.1 Drejtësia dhe të drejtat themelore

2.1.1. Nevojat dhe kapacitetet

Kjo fushë përfshin funksionimin e **sistemit të drejtësisë** në Shqipëri, d.m.th. aktivitetet relevante të Ministrisë së Drejtësisë, institucioneve të gjyqësorit dhe të vuajtjes së dënimit. Ajo përfshin çështje më të gjera si mbrojtjen e të **drejtave të njeriut** dhe procesin e reformave në lidhje me të **drejtat e pronësisë**, si dhe **lirinë e medias**. Ajo gjithashtu do të trajtojë **luftën kundër korrupsionit** nëpër institucionet publike.

Asistenca e mëparshme IPA fokusohej në reformat kyçe institucionale dhe ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm gjyqësorë, kryesisht nëpërmjet asistencës për modernizimin e sistemit të drejtësisë (projektet EURALIUS). Veç kësaj, një numër projektesh të infrastrukturës kanë rritur ndjeshëm kapacitetin e sistemit penitenciar në përputhje me standardet ndërkombëtare. BE-ja qëndron si një donator kryesor edhe në lidhje me promovimin e të drejtave të njeriut, si pasojë e disa projekteve të financuara në kuadër të instrumentit të shoqërisë civile dhe në kuadër të Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR). Asistenca IPA I në këtë fushë arrin rreth 86.500.000 Euro. Donatorë të ndryshëm janë duke ofruar mbështetje në fushën e drejtësisë dhe të drejtave themelore, si p.sh. Suedia, Italia, Holanda, si dhe Shtetet e Bashkuara dhe Kombet e Bashkuara. Banka Botërore po udhëheq procesin e reformave për të drejtat e pronësisë. Gjithashtu, të drejtat e njeriut dhe masat anti-diskriminuese marrin mbështetje nga Këshilli i Evropës dhe OSBE.

Një çështje që duhet theksuar në këtë fushë është mungesa e analizave të plota të sfidave të saj dhe, për më tepër, e zgjidhjeve të mundshme për zhvillimin e saj. Sfidat përfshijnë mungesën e qartë të efikasitetit dhe performancës së **sistemit gjyqësor**, si një e tërë, dhe një kornizë jo të plotë legjislative për të forcuar llogaridhënien, pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit. Në këtë aspekt, rekomandimet e Këshillit të Evropës (Komisionit të Venecias) do të sigurojnë kuadrin e veprimeve efektive për të forcuar pushtetin gjyqësor në arkitekturën kushtetuese shqiptare. Për më tepër, infrastruktura e gjyqësorit është e pamjaftueshme dhe ka nevojë për përmirësim, sistemet e arsimit dhe trajnimit për gjyqësorin janë të pamjaftueshme. **Korrupsioni** është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe përbën një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet Shqipëria. Niveli i lartë i korrupsionit në sistemin gjyqësor rezulton në një nivel të ulët të besimit publik. Mangësitë në kuadrin ligjor dhe normativ janë të favorshme për korrupsionin. Historiku i rezultateve tregon se dënimet dhe hetimet proaktive në fushën e korrupsionit mbeten të ulëta. Një qasje holistike kërkon krijimin e një kornize institucionale të fuqishme që parandalon korrupsionin, duke përmirësuar bashkëpunimin ndër-institucional dhe koordinimin, forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, verifikimin e deklaratave të pasurisë, si dhe kontrollin e financimit të partive politike. Vëmendje e veçantë duhet të vihet për të luftuar korrupsionin në zonat e riskuara, të tilla si prokurimi publik, shëndetësia, tatimet, arsimi, policia, doganat dhe administrata vendore. Kuadri institucional duhet të forcohet ndjeshëm, si në aspektin e personelit ashtu dhe në drejtimin e respektimit të pavarësisë së plotë të zbatimit të ligjit dhe në organet gjyqësore që kanë të bëjnë me hetimet për rastet e korrupsionit.

Menaxhimi i të drejtave të pronësisë është një shqetësim i veçantë për shkak të rëndësisë së tokës dhe tregjeve të kreditit si dhe ndikimit të tyre mbi ecurinë e ekonomisë. Legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, përfshi të drejtat e grave, personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve dhe minoriteteve si romët dhe LGBT nuk funksionon mjaftueshëm. Mbeten shqetësim **liria e medias** në Shqipëri, si dhe procedura e emërimit të anëtarëve të Autoritetit Rregullator të Medias, Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA-s), i cili nuk garanton plotësisht pavarësinë e tyre. Së fundi, Shqipëria rrezikon mospërbushjen e afatit të 2015 për **kalimin në transmetimin dixhital** (digital switch over).

2.1.2. Objektivat, rezultatet, masat dhe indikatorët

BE-ja do të mbështesë Shqipërinë me qëllim sigurimin e një sistemi të drejtësisë të pavarur, të përgjegjshëm dhe efikas, i cili është në përputhje me legjislacionin dhe praktikën më të mira të BE-së.

Rezultatet specifike që do të arrihen me asistencën e BE-së janë:

- Rishikimi i kuadrit tërësor të sistemit të drejtësisë, analiza e mangësive, dhe identifikimi në intervale sistematike i fushave që do të përmirësohen ;
- Përmirësimi i mëtejshëm i legjislacionit për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit;
- Forcimi i profesionalizmit nëpërmjet kriterëve transparente bazuar te meritat për emërimet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe administratorëve të gjykatave, si dhe nëpërmjet vlerësimeve të performancës dhe promovimit në bazë merite dhe inspektimet gjyqësore;
- Forcimi në praktikë i pavarësisë, efikasitetit, integritetit dhe llogaridhënies së gjyqësorit në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor;
- Reduktimi i ndjeshëm i kohëzgjatjes së procedurave;
- Sigurimi për zbatimin e plotë të vendimeve gjyqësore dhe forcimi i shërbimit përmbartimor gjyqësor;
- Pajtueshmëria e sistemit penitenciar me standardet ndërkombëtare, përfshi trajtimin e veçantë për kategoritë e ndryshme të paraburgosurve;
- Rishikimi i qasjes në luftën kundër korrupsionit dhe përshtatja për rritjen e efektivitetit të saj, përfshi edhe ndryshimet e nevojshme legjislative, dhe kapacitetet plotësisht funksionale të prokurorisë dhe agjencive ligjzbatuese, si dhe përmes një kornize të fuqishme institucionale për parandalimin e korrupsionit;
- Historiku i rezultateve (*track record*) në lidhje me hetimet e suksesshme, ndjekjet penale dhe dënimet përfundimtare në rastet e korrupsionit;
- Përmirësimi i menaxhimit të të drejtave të pronësisë dhe në përputhje me jurisprudencën relevante të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- Funksionimi i kornizës ligjore lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare;
- Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit dhe anti-diskriminimit në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Zbatimi i strategjisë kombëtare për integrimin e plotë shoqëror dhe ekonomik të romëve, përfshi programin e përfshirjes së romëve.

Indikatorët për matjen e rezultateve të pritshme janë (*shih listën e plotë të indikatorëve dhe objektivave në Shtojcën 2*):

- Përparimi i bërë për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit (KE);
- Indikator i përbërë Aksesi në Drejtësi (WJP) dhe Pavarësia e Sistemit Gjyqësor (FEB);
- Indikator i përbërë (Efektiviteti i Qeverisë (BB), Barra e Rregullimit Shtetëror (Forumi Ekonomik Botëror (FEB), dhe Cilësia Rregullatore (BB);
- Indikator i përbërë - Korrupsioni Global (TI) dhe Kontrolli Korrupsionit (BB);
- Indikator i përbërë - Liria e Shtypit (FH) dhe Liria për Shtyp (RWB).

Në aspektin e **masave**, mbështetja e BE-së për fushën do të përfshijë asistencën teknike dhe ngritjen e kapaciteteve për të gjitha institucionet gjyqësore. Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të ketë bashkëpunim me organizatat e tjera aktive në këtë fushë për të forcuar sinergjitë dhe për t'u dhënë ekonomive të shkallës mundësinë e asistencës. Lidhur me vijimësinë, është parashikuar të rishikohet edhe gjyqësori edhe struktura e anti-korrupsionit përpara përcaktimit të mbështetjes së mëtejshme.

Në lidhje me kushtet për **mbështetjen e fushës**, ekziston një strategji sektoriale për fushën e drejtësisë, e miratuar për 2010-2015, e cila do të rishikohet, ndërsa plani i veprimtimit për periudhën pas vitit 2014 ende nuk është hartuar. Strategjia ndërsektoriale për të drejtat e pronësisë mbi tokën është miratuar për 2011- 2015 dhe duhet të përditësohet. Strategjitë e përditësuara do të jenë pjesë e SKZHI 2014- 2020. Në mënyrë të ngjashme, pritet të jetë gati një strategji për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Ministria që ka rolin kryesor në fushën e drejtësisë është Ministria e Drejtësisë. Koordinimi me institucionet e drejtësisë është thelbësor për planifikimin e burimeve dhe përfundimisht arrijen e rezultateve. Alokimet buxhetore për këtë fushë kanë qenë historikisht të ulëta dhe është e nevojshme që ato të rriten ndjeshëm.

Fusha e të drejtave të pronësisë meriton vëmendje të veçantë për shkak të ndikimit të madh që ka në zhvillimin ekonomik, zhvillimin e bujqësisë, tregjet e kreditit dhe të tjera. Një strategji është duke funksionuar, si dhe disa fonde të donatorëve nga BE-ja dhe Banka Botërore. Parashikohet një program i veçantë me Bankën Botërore për të adresuar nevojat.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut do të mbështetet nëpërmjet masave në shënjestruara, sidomos masave të pavarura, të paktën në vitet e para të IPA II, për të harmonizuar më mirë kuadrin institucional të vendit me standardet e BE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare, për të përmirësuar më tej mekanizmin e mbrojtjes të organeve ekzistuese si (Avokati i Popullit dhe Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi). Promovimi i të drejtave të njeriut do të rritet edhe nëpërmjet mbështetjes *ad hoc* për shoqërinë civile, veçanërisht në lidhje me aksesin në drejtësi, trajtimin e të burgosurve dhe masave të tilla si qasja në shëndetësi, në favor të grupeve të rrezikuara dhe minoriteteve si romët dhe egjiptianët, si edhe LGBTI.

Për sa i përket përfshirjes së romëve, në përputhje me Dokumentin Strategjik të Zgjerimit për 2013-14, IPA II do të mbështesë dhe inkurajojë seminarat periodike dhe aktivitetet në vazhdimësi me një monitorim rigoroz për zbatimin e konkluzioneve operacionale nëpërmjet komiteteve të monitorimit të vendit. Veç kësaj, financimi IPA II nëpërmjet 'instrumentit' për romët do të financojë masat mbështetëse, rënë dakord në seminarat kombëtare, dhe përmirësimin e bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Si përfundim, ka një perspektivë për të mbështetur me asistencë këtë fushë, mundësisht nën-fushat, përmes një përfaqëse sektoriale dhe kontratave të reformës sektoriale (mbështetje buxhetore e fushës) me kusht që të përmbushen kushtet.

2.1.3. Llojet e financimit

Asistenca për reformat e drejtësisë do të jepet mundësisht përmes mbështetjes buxhetore sipas fushës nëse plotësohen kushtet. Para se të vendoset pranueshmëria, kontratat e shërbimit, binjakëzimet dhe mbështetje të tjera¹² do të përdoren për të ofruar asistencë. Në lidhje me të drejtat e pronës, do të ketë bashkëpunim të ngushtë me Bankën Botërore, e cila tashmë është e angazhuar në mënyrë aktive në këtë fushë. Asistenca për përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore dhe penitenciare në drejtim të ndërtesave dhe pajisjeve do të ofrohet nëpërmjet kontratave të punës dhe kontratave të furnizimit ose përmes mbështetjes buxhetore të fushës nëse është e mundur, me kusht që ka përkushtim të qartë dhe përparim në zbatimin e reformave në këtë fushë dhe infrastruktura mund të vihet në punë dhe të mirëmbahet. Do të mbështetet pjesëmarrja në programet relevante të BE-së ndërsa detajet do të përcaktohen më vonë në kohën e programimit.

2.1.4 Risqet

Një nga **risqet** që mund të ndikojë në arritjen e objektivave të synuara dhe rezultatet janë vonesat për shkak të burimeve të kufizuara financiare dhe njerëzore në dispozicion për të kryer procesin e reformave. Prandaj është e rëndësishme të forcohen të dyja si (i) kapacitetet e autoriteteve shqiptare për të monitoruar progresin e reformave dhe për të ndërmarrë veprime korigjuese, edhe (ii) përfshirja e monitorimit të pavarur për të rekomanduar masa korigjuese të tilla si ngritja e kapaciteteve shtesë apo mbështetja financiare shtesë. Gjithashtu, këto risqe do të monitorohen përmes dialogut të politikave mbi prioritetet përkatëse kyçe që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar (*shih më sipër seksionin 2.1*).

2.2. Çështjet e brendshme

2.2.1. Nevojat dhe kapacitetet

Fokusi i kësaj fushe është përqendruar te bashkëpunimi policor dhe lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmi dhe droga, trafikimi i qenieve njerëzore, pastrimi i parave, migrimi dhe politika e azilit, si dhe menaxhimi integruar i kufijve (MIK).

Mbështetja e IPA-s deri tani është përqendruar në rritjen e kapaciteteve të Policisë së Shtetit shqiptar dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese. Asistenca është dhënë kryesisht përmes misioneve këshilluese, të cilët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen për luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikëve të paligjshme, si dhe zhvillimin e menaxhimit të integruar të kufijve. Mbështetja e IPA I ka qenë e përqendruar në zbatimin e kuadrit rregullator për anti-korrupsionin dhe kundër pastrimit të parave, për planifikimin e mjeteve efektive për të luftuar krimin (p.sh. sekuestrimi i asetëve). Një numër projektesh të infrastrukturës kanë krijuar ose përmirësuar facilitetet e Policisë, përfshi pikat e kalimit kufitar. Mbështetja e IPA-s për çështjet e brendshme deri tani ka arritur shumën prej rreth 26.500.000 Euro. Qeveria e SHBA është donator plotësues në këtë fushë.

¹² Për shembull nga asistenca me shumë-përfitues ose TAIEX

Për sa i përket çështjeve të brendshme, sfidat kryesore që kanë të bëjnë me integrimin në BE, të cilat duhet të adresohen nga asistenca e ardhshme, përfshijnë nevojën për zbatimin e ligjit dhe të një historiku rezultatesh (*track rekord*) të besueshëm dhe më proaktiv të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve të formës së prerë, veçanërisht në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ekziston një nevojë e përgjithshme për zbatimin më të mirë të legjislacionit, në veçanti në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave, sekuestrimi i asetëve, migracionit të parregullt dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe të drogave.

2.2.2. Objektivat, rezultatet, masat dhe indikatorët

BE do të ndihmojë Shqipërinë të krijojë një sistem të zbatimit efektiv dhe efikas të ligjit, që është në gjendje të paraqesë një historik rezultatesh (*track rekord*) të besueshëm në luftën kundër krimit të organizuar.

Rezultatet e pritshme që do të arrihen me asistencën e BE-së janë:

- Historiku i rezultateve (*track rekord*) të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në vazhdimësi për rastet e krimit të organizuar;
- Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit të anti-mafias dhe pastrimit të parave dhe garantimi i zbatimit të tyre me efektivitet;
- Përmirësimi i Menaxhimit të Integruar të Kufirit, përfshi (migracionin e parregullt) përmes rritjes së kapaciteteve të policisë kufitare, përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet pikave të kalimit kufitar dhe ndër-agjencive, si dhe investimet në infrastrukturë;
- Përmirësimi i adresimit të trafikimit të qenieve njerëzore;
- Realizimi më me efikasitet i aksioneve kundër prodhimit të drogës dhe trafikimit, impakti pozitiv në luftën për parandalimin e drogës, si dhe reduktimi i kërkesës dhe ofertës.

Indikatorët për arritjen e rezultateve të pritshme përfshijnë (*shih Shtojcën 2*):

- Përparimi i bërë në drejtim të përmbushjes së kriterëve të anëtarësimit (KE);

Llojet e masave do të përfshijnë asistencën teknike për ngritjen e kapaciteteve dhe reformat e politikave lidhur me zbatimin e ligjit, përfshi menaxhimin e integruar të kufirit. Asistenca do të jepet për përmirësimin e infrastrukturës për policinë dhe prokurorinë në drejtim të ndërtesave dhe pajisjeve, me kusht që të ketë një angazhim të qartë dhe përparim në zbatimin e reformave dhe se infrastruktura mund të vihet në punë dhe të mirëmbahet.

Në lidhje me kushtet për **mbështetjen e fushës**, strategjia kombëtare ndërsektorale për luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe terrorizmit për 2013-2020 dhe plani i veprimit për 2013-2016 funksionojnë që nga muaji korrik 2013. Këto strategji do të jenë pjesë e SKZHI 2014-2020, si dhe strategjia e ardhshme kombëtare për menaxhimin e integruar të kufirit dhe strategjia kombëtare për rendin publik. Ministria që ka rolin kryesor në fushën e punëve të brendshme është Ministria e Punëve të Brendshme e cila është përgjegjëse për programet e shpenzimeve të Policisë së Shtetit. Duhet të përmirësohet koordinimi i policisë dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, të tilla si prokuroria, gjykatat, dhe njësitë e përbashkëta të hetimit. Në mënyrë të ngjashme, duhet të forcohet monitorimi dhe koordinimi i donatorëve përmes grupeve sektorale të punës. Në tërësi, qasja sektorale mund të parashikohet në gjysmën e dytë të IPA II, po qe se kushtet janë përgatitur,

veçanërisht në lidhje me strategjitë ekzistuese, si dhe koordinimin dhe monitorimin e performancës.

2.1.4. Lloji i financimit

Asistenca për reformat që lidhen me punët e brendshme dhe investimet do të jepet mundësisht nëpërmjet mbështetjes buxhetore sektoriale nëse plotësohen kushtet. Do të përdoren kontratat e shërbimit, binjakëzimet dhe mbështetje të tjera¹³ para se të vendoset pranueshmëria. Do të mbështetet pjesëmarrja në programet relevante të Bashkimit Evropian ndërsa detajet të përcaktohen më vonë në kohën e programimit.

2.1.5 Risqet

Një nga **risqet** që mund të ndikojë në arritjen e objektivave të synuara dhe rezultatet janë burimet financiare dhe njerëzore në dispozicion për të kryer procesin e reformave. Prandaj është e rëndësishme të forcohen të dyja si (i) kapacitetet e autoriteteve shqiptare për të monitoruar progresin e reformave dhe për të ndërmarre veprime korigjuese, edhe (ii) përfshirja e monitorimit të pavarur për të rekomanduar masa korigjuese që duhet të ndërmerren. Dialogu politik për prioritetet kyçe të lidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar (*shih më sipër seksionin 2,1*) do të luajë një rol të rëndësishëm në monitorimin e risqeve dhe sugjerimin e masave korigjuese.

3. Mjedisi dhe masat për klimën

3.1. Nevojat dhe kapacitetet

Kjo fushë mbulon fuqizimin e kapaciteteve, mbështetjen për miratimin e legjislacionit të përafuar të BE-së dhe investimet e infrastrukturës, sidomos menaxhimin e ujërave, përmytjeve dhe mbetjeve, si dhe masat për ndryshimin e klimës.

Asistenca e mëparshme përfshinte operacione të ndryshme (asistencë teknike, pajisje dhe investime) për përafrimin e vendit me kuadrin e gjerë dhe kompleks rregullator të BE-së dhe për të formësuar më mirë zhvillimin e politikave. Mbështetja përqendrohej në kapacitetet e institucioneve qendrore dhe vendore për të zbatuar legjislacionin e fushës përkatëse dhe për të monitoruar nivelin e ndotjes (ajrit dhe ujit). Asistenca gjithashtu përfshinte një seri projektsh të infrastrukturës për ndërtimin e impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura përgjatë bregdetit Adriatik me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujit të detit. Fusha të tjera plotësuese si mbrojtja e natyrës dhe ndryshimet klimatike kanë marrë gjithashtu mbështetjen e IPA. Në tërësi, asistenca e BE-së gjatë periudhës 2007-13 llogaritet në rreth 126 milionë Euro. Donatorë të ndryshëm ofrojnë asistencë për fushën; ndërmjet tyre IFN me kredi nga Banka Botërore, BEI, për shembull nga asistenca shumë-përfituese ose TAIEX BERZH, si dhe donatorë të tjerë si Gjermania, Italia, Japonia, Austria, Suedia, Zvicra dhe Kombet e Bashkuara.

Mësimet e nxjerra nga IPA I janë: (a) ngritja e kapaciteteve dhe investimeve kërkon një nivel minimal të burimeve njerëzore në drejtim edhe të aftësisë dhe numrit; (b) pronësia për investimet e financuara nga BE rrezikohet në se ato nuk lidhen me strategjitë dhe buxhetet e fushës të

¹³ Për shembull nga asistenca me shumë-përfitues ose TAIEX

ministrive relevante; (c) se zhvillimi i infrastrukturës kërkon koordinim të fuqishëm dhe efikas ndërmjet ministrive në nivel qendror dhe me institucionet e qeverisjes vendore; dhe (d) se disponueshmëria e tokës për ndërtimin e infrastrukturës është një pengesë serioze në Shqipëri. Veç kësaj, kushtet themelore në aspektin e lejeve të ndërtimit, titujve të tokës dhe burimeve për funksionimin dhe mirëmbajtjen duhet të plotësohen për të garantuar qëndrueshmërinë e asistencës. Së fundi, studimet e ardhshme të fizibilitetit duhet të vlerësojnë diligjencën e duhur institucionale.

Shqipëria është në një fazë shumë të hershme të përafrimit me *acquis* në këtë fushë dhe sfidat janë ende të shumta dhe të ndryshme. Nevojat prioritare përfshijnë zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve në qeverisjen e nivelit qendror dhe vendor për zhvillimin dhe zbatimin e politikave. Nevojitet përafrimi i mëtejshëm me politikat dhe legjislacionin e mjedisit dhe klimës të BE-së, dhe garantimi për zbatimin efektiv. Kjo përfshin në veçanti legjislacionin për klimën, monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimit të gazeve serë; vendimi i KE-së për ndarje masash; gazet e florinuara; lëndët ozonholluese; standardet e efikasitetit të mjeteve motorike dhe cilësisë së karburanteve; kapja dhe ruajtja e karbonit, si edhe legjislacion tjetër përkatës.

Nevojat për investime në nën-sektorin e ujit janë të rëndësishme¹⁴, megjithëse ekzistojnë kufizime të kapaciteteve menaxhuese. Po kështu është i pazhvilluar menaxhimi i mbetjeve, me vende grumbullimi plehrash shpesh të paligjshme dhe landfillle informale, sisteme të dobëta për grumbullimin e mbeturianve dhe riciklimin minimal të mbetjeve. Përdorimi i disa investimeve, sidomos në sektorin e ujit të mbështetur nga IPA I, nuk është ende në nivel të kënaqshëm. Shqipëria është e prekshme ndaj ndryshimeve klimatike, sidomos nga përmblytjet dhe erozioni i tokës, në kohë të caktuara. Meqë Shqipëria mbështetet kryesisht te hidrocentralet, rreshjet e parregullta herë pas here shkaktojnë ndërprerje në prodhimin e energjisë elektrike. Në tërësi, nevojiten masa për vlerësimin e rrezikut të ndryshimeve klimatike, si edhe masa për përshtatjen në këto fusha.

3.2. Objektivat, rezultatet, masat dhe indikatorët

Asistenca në periudhën e parë të IPA II (2014-2017) do të mbështesë Shqipërinë me synimin (a) për të ngritur kapacitetet e menaxhimit të fushës në përputhje me politikat e BE-së dhe për të konsoliduar përpjekjet e mëhershme, (b) për të kontrolluar funksionimin dhe ruajtjen e investimeve të infrastrukturës publike ekzistuese dhe të re në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. Një objektiv tjetër është të përgatisë një listë projektesh të maturuara për investimet e mundshme dhe të zbatueshme të infrastrukturës mjedisore. Në periudhën e dytë të IPA II (2017-2020), është parashikuar të sigurohet mbështetje shtesë për investimet aktuale në fushat prioritare.

Rezultatet e pritshme që do të arrihen me asistencën e BE-së janë:

- Përafrimi i mëtejshëm i politikave dhe legjislacionit të mjedisit dhe ndryshimit të klimës me legjislacionin dhe praktikat më të mira të BE-së dhe zbatimi në mënyrë efektive;

¹⁴ Nevojiten të paktën 2.4 miliard Euro në përputhje me direktivën e BE-së për trajtimin e ujërave të ndotura, si edhe çdo vit 52 milion Euro për shpenzimet operative.

- Përmirësimi i qëndrueshmërisë së investimeve përmes koordinimit më të mirë të palëve të interesuara;
- Garantimi i financimit të shëndoshë për shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes;
- Përcaktimi i projekteve të maturuara për investimet në përputhje me masterplanet ekzistuese;
- Përmirësimi i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura; prioritarizimi i grumbullimeve më të mëdha dhe zonave të ndjeshme mjedisore në përputhje me legjislacionin e BE-së;
- Një master plan për investimet e menaxhimit të mbetjeve, sidomos riciklimin, dhe një listë projektesh të maturuara për zbatimin janë në dispozicion;
- Rritja e numrit të impianteve për menaxhimin e mbetjeve, sidomos riciklimin;
- Funksionimi i mekanizmit të vetëm të përzgjedhjes për identifikimin e investimeve prioritare në ujë, mbrojtjen nga përmytjet, menaxhimin e mbetjeve dhe ndryshimet klimatike, konsiderohen për kombinim të granteve të IPA II me kredi të IFN;
- Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive dhe planeve të veprimit për vlerësimin e rrezikut të ndryshimeve klimatike dhe të përshtatjes në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar.

Indikatorët për matjen e rezultateve të pritshme janë: (*Shih gjithashtu Shtojcën 2*):

- Përparimi i bërë në drejtim të përmbushjes së kriterëve të anëtarësimit (KE);
- Popullsia e lidhur me sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura (statistikat kombëtare).

Në aspektin e mbështetjes për **masat**, nevojitet një diferencim midis: (a) zhvillimit të politikave, legjislacionit, planifikimit dhe përgatitjes së investimeve dhe (b) mbështetjes për zbatimin e politikave dhe investimeve aktuale, përfshi garantimin e funksionimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të mjedisit dhe të aksionit për klimën, si dhe përafrimi i kuadrit rregullator me legjislacionin e BE-së do të mbështeten përmes asistencës teknike, e dhënë nëpërmjet binjakëzimit, kontratave të shërbimit, TAIEX-it dhe agjencive ndërkombëtare të specializuara. Ekspertiza teknike do të forcojë gjithashtu kapacitetet e institucioneve qendrore dhe vendore për të zbatuar masat përkatëse rregullatore për mbrojtjen e mjedisit. Nëse është e nevojshme, mbështetja do të përfshijë pajisje specifike për të monitoruar standardet e politikave sektoriale. Mbështetja do të jepet edhe për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe integritit të mirëfilltë të mjedisit në fusha të tjera të politikës si energjia, transporti, bujqësia.

Përgatitja e projekteve të maturuara dhe të zbatueshëm për investimet infrastrukturore do të mbështetet përmes asistencës teknike për fizibilitetin, vlerësimin, vlerësimin e ndikimit, projektimet dhe studime të tjera. Parashikohet që të gjitha fondet e donatorëve dhe financimeve të tjera të BE-së të përfshihen në një proces të vetëm të përcaktimit të prioritetëve dhe përzgjedhjes. Fondet IPA II kryesisht do të investohen për studimet e fizibilitetit, vlerësimet e ndikimit apo studimet e projektimit në mënyrë që të përgatiten investime fitimprurëse të cilat plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për financim nga IFN ose donatorë të tjerë.

Për të garantuar se kreditë janë në gjendje të adresojnë nevojat prioritare të zhvillimit dhe për të përshpejtuar rritjen e investimeve, duke pasur parasysh burimet e kufizuara publike në dispozicion, fondet e IPA II do të mund të ofrohen për të bashkëfinancuar investimet aktuale dhe kreditë e kombinuara me një sasi të kufizuar të fondeve të grantit. Lloji korrekt i investimeve të

bashkë-financimit varet nga burimet në dispozicion, cilësia dhe matura e projekteve të propozuara, bashkëpunimi me donatorë të tjerë, përfundimi i vlerësimeve aktuale dhe studimeve të fizibilitetit, si dhe nga disponueshmëria e fondeve të mjaftueshme për funksionimin në mënyrë adekuate dhe ruajtjen e investimeve (*shih më sipër*). Mënyra e preferuar për dhënien e asistencës është menaxhimi i fondeve të BE-së nga i njëjti donator që ofron kredinë për investime, në mënyrë që të rrisë efikasitetin e zbatimit në lidhje me kohën dhe kontraktimin e ekonomive të shkallës.

Në lidhje me kushtet për **mbështetjen e fushës**, duhet theksuar se ekzistojnë ministri, strategji dhe buxhete të ndryshme që mbulojnë menaxhimin e ujit dhe mbetjeve. Gjithashtu, institucionet e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për infrastrukturën në nivel lokal. Çështjet e ujit dhe të mbetjeve duhet të trajtohen veç e veç në mënyrë për të reduktohet kompleksiteti dhe të mundësohet menaxhimi efektiv i mbështetjes së fushës. Për sa i përket strategjive, do të integrohen në SKZHI e re Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, Master plani i Investimeve për Ujin dhe Kanalizimet (2011-2017) dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve (2012-2025). Në këtë drejtim, është thelbësore të garantohet që strategjitë sektoriale dhe planet e veprimit janë plotësisht në përputhje me politikat relevante të BE-së dhe kërkesat e *acquis*. Siç përmendet më sipër, përvoja nga asistenca e kaluar ka treguar se burimet e alokuara aktualisht nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar në mënyrë adekuate shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes. Këto mangësi duhet të adresohen si çështje me prioritet, para se asistenca e mëtejshme për investimet aktuale të arsyetohet. Parashikohet për të mbështetur ministritë e ndryshme në gjysmën e parë të IPA II (2014-2020) duke u përqendruar në zhvillimin e elementeve themelore të një përqsasje sektoriale siç janë zhvillimi i planit për zbatimin e strategjisë, planifikimi i buxhetit, zhvillimi institucional dhe organizativ, si dhe koordinimi mes të tjerash. Sapo elementët themelorë të funksionojnë, parashikohet të vazhdojë asistenca me një përqsasje sektoriale të përcaktuar më qartë e cila mund të përfshijë kontratat e reformës sektoriale (mbështetja buxhetore sektoriale) si mekanizëm i preferuar i ofrimit për asistencën e BE-së.

3.3. Lloji i financimit

Mbështetja buxhetore sektoriale është lloji i preferuar i financimit në fushën e mjedisit, ose nën-fushat përkatëse si menaxhimi i ujit ose mbetjeve, në se plotësohen kushtet. Para se të vendoset pranueshmëria, kontratat e shërbimit, binjakëzimet dhe mbështetje të tjera¹⁵ do të përdoren për të ofruar asistencë. Për sa i përket investimeve, është parashikuar një qasje koordinuese për kombinimin e kredive të IFN me grantet e IPA përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Do të mbështetet pjesëmarrja në programet relevante të BE-së ndërsa detajet do të përcaktohen më vonë në kohën e programimit.

3.4. Risqet

Ekziston **risku** që burimet në dispozicion si në aspektin e mjeteve dhe të burimeve njerëzore nuk janë të mjaftueshme. Si rrjedhojë, strategjia për vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve do të

¹⁵ Për shembull nga asistenca me shumë-përfitues ose TAIEEX

përqendrohet në përbalueshmërinë e investimeve të reja dhe të garantohet që investimet ekzistuese si dhe ato të reja të vihen në punë dhe të mirëmbahen në mënyrë adekuate. Investimet e reja do të mbështeten kur të vihen në funksionim kërkesat themelore për menaxhimin adekuat. Është i nevojshëm bashkëpunimi i ngushtë me IFN për të rritur efikasitetin.

4. Transporti

4.1. Nevojat dhe kapacitetet

Kjo fushë mbulon ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin e politikave, përafrimin e legjislacionit dhe investimet në transport, përfshi integrimin rajonal dhe atë në BE, si edhe rrjetet hekurudhore, aviacionin dhe portet.

Për këtë sektor janë mobilizuar fondet e IPA I për investimet e infrastrukturave të vogla dhe të mesme rrugore në bashkëpunim me IFN, që llogariten mbi 91 milionë Euro. Ende sigurohet asistencë e konsiderueshme teknike për përgatitjen e legjislacionin kombëtar, në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së, ngritjen e kapaciteteve, si dhe përgatitjen e dokumenteve strategjike. Veç kësaj, asistencë IPA I është dhënë për të krijuar një rrjet të unifikuar rrugor që lidh komunitetet periferike me linjat kryesore kombëtare dhe rajonale të transportit, veçanërisht Korridorin VIII (lindje-perëndim nga Durrësi në Pogradec) të Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) dhe SEETO Route 2 (aksi veri-jug nga Shkodra deri në Tepelenë-Gjirokastrë. BE-ja ka financuar edhe kryqëzimet gjatë këtyre dy akseve, p.sh. by-paset e Vlorës dhe Rrogozhinës dhe ka mbështetur ndërtimin dhe përmirësimin e rrugëve rurale. Në aspektin e koordinimit të donatorëve, fondet për zhvillimin e infrastrukturës së transportit janë dhënë kryesisht në formën e huave nga IFN si Banka Botërore, BEI, BERZH dhe gjithashtu nga bashkëpunimi bilateral me Gjermaninë dhe Italinë. Disa projekte të transportit janë financuar nga Fondi Kuvajitian për Zhvillimin Ekonomik Arab (KFAED), Fondi Saudit për Zhvillim, Fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar i krijuar nga vendet anëtare të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës dhe Fondi i Abu Dhabi-t.

Përveç kufizimeve të përmendura më lart për fushën e mjedisit lidhur me infrastrukturën e madhe, sektori i transportit (që ka përthithur investime të rëndësishme periudhën e fundit) vuan nga disponueshmëria e kufizuar e fondeve për mirëmbajtjen. Kjo është një arsye për shqetësim serioz. Prandaj është e rëndësishme që si burimet edhe mjetet për menaxhimin e financave publike, të nevojshme për të siguruar angazhime afatgjata, duhet të jenë një parakusht për investime të suksesshme në infrastrukturë. Vlerësimet institucionale, si vlerësimet e dilijencës së duhur të institucioneve zbatuese, duhet të përfshihen në studimet e ardhshme të fizibilitetit. Është thelbësore që planifikimi i investimeve në infrastrukturën e transportit është bërë në përputhje me prioritetet e identifikuara në planet strategjike të qeverisë dhe planeve¹⁶ gjithëpërfshirëse të zhvillimit të rrjetit të Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO). Veç kësaj, duhet të kryhet mirëmbajtja e infrastrukturës në përputhje me mjetet dhe manualët tashmë ekzistuese të menaxhimit të aseteve.

Sfidat në sektorin e transportit përfshijnë alokimin joadekuat të burimeve për mirëmbajtjen e infrastrukturës (25% e asaj që është e nevojshme). Veç kësaj, Shqipëria ka nevojë të

¹⁶ Shih <http://www.seetoint.org/library/multi-annual-plans/>

konsiderueshme për investime shtesë në përputhje me planet e punës të SEETO-s. Është i nevojshëm gjithashtu përcaktimi i qartë i prioriteteve kombëtare për investime. Këto duhet të përfshijnë një numër relativisht të vogël projektesh të menaxhueshme për të llogaritur në kohë përfundimin në vend të alokimit të investimeve mbi një numër të madh projektesh, ku nuk mund të sigurohet një përfundim në kohë. Gjithashtu, ka sfida të veçanta për të zhvilluar më tej politikat e transportit, për shembull në lidhje me multimodalitetin, standardet e sigurisë dhe të sigurimit për të gjitha llojet e transportit, lëvizjen urbane, tregun e aviacionit, dhe të tjera në përputhje me politikat e BE-së, në veçanti politikat e masave për klimën.

4.2. Objektivat, rezultatet, masat dhe indikatorët

Për shkak të çështjeve të mirëmbajtjes së pamjaftueshme të infrastrukturës së transportit, asistenca në pjesën e parë të IPA II (2014-2017) do të mbështesë Shqipërinë me objektivin kryesor për të zhvilluar më tej politikat e transportit dhe për të ruajtur dhe operuar investimet ekzistuese të infrastrukturës publike në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. Përveç kësaj, objektivi është për të krijuar një seri projektesh të maturuara dhe të zbatueshme të infrastrukturës. Në pjesën e dytë të IPA II (2017-2020), është parashikuar që të sigurohet mbështetje shtesë për investimet aktuale.

Rezultatet e pritshme që do të arrihen me asistencën e BE-së janë:

- Përmirësimi i mëtejshëm i përafrimit të politikave dhe legjislacionit të transportit me legjislacionin dhe praktikën më të mira të BE-së;
- Përmirësimi i kapaciteteve administrative për menaxhimin e politikave të transportit;
- Qëndrueshmëria e projekteve të investimit e përmirësuar përmes mbështetjes së programeve realiste të mirëmbajtjes dhe koordinimit të palëve të interesuara për shpenzimet operative financiare;
- Përmirësimi në mënyrë të konsiderueshme i sigurisë së transportit, sidomos në lidhje me rrugët dhe aviacionin;
- Rritja e investimeve në infrastrukturën e transportit në përputhje me prioritetet e planeve të zhvillimit të rrjetit të SEETO-s;
- Krijimi i një mekanizmi të vetëm përzgjedhjeje dhe funksionimi për identifikimin e investimeve prioritare të konsideruara për kombinimin e granteve të IPA II me kreditë e INF në përputhje me strategjitë dhe planet ekzistuese të transportit.

Indikatorët për matjen e rezultateve të pritshme janë (*shih tabelën 2 në shtojcën 2*):

- Përparimi i bërë për përmbushjen e kritereve të anëtarësimit (KE);
- Indikator i performancës së logjistikës - Rezultati (BB).

Lidhur me masën që do të mbështetet, ekziston nevoja për të diferencuar: (a) zhvillimi dhe zbatimimi i politikave dhe legjislacionit, si dhe planifikimi dhe përgatitja e investimeve dhe (b) mbështetje për mirëmbajtjen e investimeve dhe (c) të investimeve aktuale.

Zhvillimi dhe zbatimimi i **politikave të transportit**, si edhe përafrimi i kuadrit **regullator** me legjislacionin e BE-së do të mbështetet përmes asistencës teknike. Ekspertiza teknike gjithashtu do të ndihmojë në përgatitjen e projekteve të maturuara dhe të zbatueshme për investime në infrastrukturë. Është parashikuar që të gjitha fondet e donatorëve të BE-së dhe financime të tjera të përfshihen në një proces të vetëm të përzgjedhjes dhe caktimit të prioriteteve për projektet e

investimeve. Fondet e IPA II kryesisht do të përdoren për studime fizibiliteti, vlerësimeve të impaktit apo studime të projektimit ose shërbime të tjera në mënyrë që të përgatiten investime fitimprurëse të cilat plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë për financim kredie nga IFN ose donatorë të tjerë.

Fondet e IPA II do të kontribuojnë gjithashtu edhe për strukturimin e programeve për **mirëmbajtjen** e investimeve. Megjithatë, fondet e IPA II nuk mund të zëvendësojnë detyrimin e përfituesit për të siguruar burimet për operimin dhe mirëmbajtjen e investimeve. Asistenca e BE-së mund të përdoret për të krijuar mekanizmat dhe për të siguruar bashkëfinancimin për një kohë të kufizuar me një ulje të pjesës së bashkë-financuar nga IPA II me kalimin e kohës.

Në mënyrë që të sigurohet se kreditë janë në gjendje të adresojnë nevojat prioritare të zhvillimit dhe të përshpejtojnë investimet, duke marrë parasysh burimet e kufizuara publike në dispozicion, dhënia e fondeve IPA II do të koordinohet në përputhje me Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) për të bashkëfinancuar investimet e caktuara dhe për të kombinuar kreditë e IFN me një sasi të kufizuar të fondeve të grantit. Në këto raste, mënyra e preferuar për dhënien e asistencës është menaxhimi i fondeve të BE-së nga i njëjti donator që jep kreditë, me qëllimin për të rritur efikasitetin e zbatimit në lidhje me kohën dhe shfrytëzimin e ekonomive të shkallës.

Në aspektin e kushteve për **mbështetjen e fushës**, duhet të theksohet se ka ministri, strategji dhe buxhete të ndryshme që janë të angazhuar në sektorin e transportit: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës është kryesuese në këtë sektor, ndërsa institucionet e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për infrastrukturën në nivel lokal. Prioriteti në gjysmën e parë të IPA II (2014-2020) është të mbështesë Ministrinë e ndryshme të zhvillojnë elementet bazë të një përfaqëse sektoriale si zhvillimi i politikave dhe strategjisë, planifikimi i buxhetit, zhvillimi institucional dhe organizativ, si dhe koordinimi. Sapo të jenë plotësuar kushtet themelore, parashikohet të vazhdojë asistenca me përfaqëset sektoriale të përcaktuara më qartë, të cilat mund të përfshijnë kontratat e reformave sektoriale (mbështetja buxhetore sektoriale) si mekanizmi i preferuar i ofrimit për asistencën e BE-së.

4.3 Llojet e financimit

Mbështetja buxhetore sektoriale është lloji i preferuar i financimit në sektorin e transportit, apo nën-sektorët përkatës si transporti hekurudhor ose rrugor, nëse plotësohen kushtet. Para se të vendoset pranueshmëria, kontratat e shërbimit, binjakëzimet dhe mbështetje të tjera¹⁷ do të përdoren për të ofruar asistencën. Për sa i përket investimeve, është parashikuar një përfaqëse koordinuese për kombinimin e kredive të IFN me grantet e IPA përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Mirëmbajtja e rrugëve mund të mbështetet nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë të tjerë, p.sh. Banka Botërore. Do të mbështetet pjesëmarrja në programet relevante të BE-së ndërsa detajet do të përcaktohen më vonë në kohën e programimit.

4.4 Risqet

¹⁷ Për shembull nga asistenca me shumë-përfitues ose TAIEEX

Ekziston **risku** që burimet e disponueshme si në aspektin e mjeteve dhe të burimeve njerëzore nuk janë të mjaftueshme. Prandaj strategjia për vlerësimin e rreziqeve do të përqendrohet në përballueshmërinë e investimeve të reja dhe të sigurohet se investimet ekzistuese si dhe ato të reja janë operuar dhe mirëmbajtur në mënyrë adekuate. Investimet e reja do të mbështeten kur kërkesat themelore për menaxhimin adekuat të funksionojnë. Është i nevojshëm bashkëpunimi i ngushtë me IFN për të rritur efikasitetin. Vlerësimet e mbështetura në dilijencën e duhur do të zbatohen plotësisht në aktivitetet përgatitore të projektit.

5. Konkurrueshmëria dhe novacioni

5.1. Nevojat dhe kapacitetet

Fusha e veprimit e këtij sektori përfshin konkurrencën e ekonomisë me fokus të veçantë në zhvillimin e NVM-ve dhe promovimin e turizmit, të cilat kanë një potencial të veçantë për rritjen ekonomike. Ky sektor merr mbështetje të rëndësishme nga BE-ja për forcimin e **qeverisjes ekonomike** të Shqipërisë, përveç reformës në administratën publike dhe menaxhimin financiar publik përmendur më lart në seksionin 1.

Mbështetja e programit kombëtar IPA I deri tani është fokusuar në aspektet rregullatore dhe të konkurrueshmërisë, si edhe në këshilla për hartimin e politikës së NVM-ve, përfshi mbështetjen teknike për bizneset që të kenë akses në kreditim. Shuma e akorduar nga IPA I ka qenë 13,4 milion EUR. Përveç kësaj, disa instrumente rajonale kreditimi kanë qenë të disponueshme në kuadrin e programeve me shumë përfitues, me qëllim rritjen e investimeve. Për sa i përket mbështetjes së donatorëve të tjerë, Italia ka ngritur një linjë kreditimi për NVM-të, ndërsa Gjermania, Zvicra, OKB dhe SHBA janë duke mbështetur aspekte të ndryshme të zhvillimit të politikave dhe forcimit të kapaciteteve të NVM-ve. Për sa i përket turizmit, BE-ja ka mbështetur promovimin trashëgimisë kulturore dhe rikualifikimin urban në qytete të ndryshme (p.sh. Korçë, Elbasan, Shkodër dhe Berat). Në fushën e turizmit, Shqipëria përfiton asistencë edhe nga Gjermania, OKB dhe Italia përmes OJF-ve.

Sfidat kryesore të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare lidhen me respektimin e sundimit të ligjit (ekzekutim i dobët kryesisht i kontratave, problemet dhe korrupsioni në gjyqësor, administratë tatimore, doganore dhe vendore). Ka shqetësime në lidhje me sigurinë e titujve të tokës dhe pronësisë së tokës dhe për pengesat që hasin bizneset në sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm me energji elektrike. Pengesë shtesë përbën aksesin i kufizuar në shërbimet dhe kreditimin e biznesit. Kapacitetet njerëzore janë të kufizuara, si rezultat i sistemit të dobët arsimor dhe formimi profesional që ka një disraport mes formimit dhe aftësive që kërkon tregun. Integrimi i ekonomisë shqiptare në rrjetet dhe tregjet rajonale dhe të BE-së është i kufizuar. Potenciali i NVM-ve, sidomos në industrinë e turizmit, është i nënzhvilluar. Lidhja midis turizmit dhe ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe rikualifikimit urban mund të përbente një burim të rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe zhvillimin. Më tej, Shqipëria duhet të përmirësojë mjedisin e biznesit, duke mundur aksesin në informacion përmes disponueshmërisë së brezit të gjerë, që të reduktohet si hendeuku digjital brenda vendit, ashtu edhe hendeuku digjital me BE-në. Po kështu, Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet e saj për të zhvilluar kapacitetet kërkimore dhe novacionit, që të forcojë konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike. Në lidhje me instrumentet e kreditimit, Shqipëria zbaton disa “fonde”, p.sh. linja e kreditimit dhe fondi i garancisë së kreditimit për

zhvillimin e NVM-ve¹⁸, fondi i garancisë për eksportin, fondi i ekonomisë krijuese, fondi i novacionit dhe fondi i konkurrueshmërisë. Agjencia Shqipëria e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) menaxhon shumicën e tyre, por nevojitet koordinim më i mirë i këtyre fondeve.

Së fundi, Shqipëria duhet të shfrytëzojë më mirë mundësinë e lidhjes me tregun ndërkombëtar të gazit përmes Tubacionit Trans-Adriatik (TAP) që do të ndërtohet, i cili do të sjellë gazin nga Azerbajxhani në Evropë përmes Shqipërisë.

5.2. Objektivat, rezultatet, masat dhe indikatorët

BE-ja do të ndihmojë Shqipërinë me **objektivin** për të rritur konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare, në veçanti zhvillimin e NVM-ve konkurruese, duke rritur integrimin e tregut dhe kontributin e eksporteve në rritjen ekonomike, si edhe për të përgatitur Shqipërinë që të shfrytëzojë mundësinë që vijnë nga aksesit i ardhshëm në tregun e gazit përmendur më lart.

Me ndihmën e BE-së pritet të arrihen **rezultat** e mëposhtme:

- Përmirësim të aksesueshmërisë dhe kërkesës për shërbime zhvillimi biznesi;
- Përmirësim të aksesit të NVM-ve në kreditim;
- Zhvillim i mëtejshëm i integritit të ekonomisë shqiptare në tregjet rajonale dhe tregjet e eksporteve, përfshi turizmin;
- Përmirësim të qeverisjes së mirë dhe luftës kundër informalitetit në sektorë kyçë si energjetika, turizmi, kultura, etj;
- Shfrytëzim më i mirë i mundësive ekonomike që sjell aksesit në tregun e gazit;
- Pjesëmarrja e Shqipërisë në programin e BE-së për reformimin e konkurrueshmërisë.

Indikatorët për matjen e rezultateve të pritshme janë: (*Shih Shtojcën 2*):

- Progresi i bërë në arritjen e kriterëve të anëtarësimit (KE);
- Të bërit biznes – distancë nga kufiri (BB)

Për sa i përket **masës** që do të mbështetet, shërbimet e biznesit dhe aksesit në kapital dhe huamarrje si edhe garancitë e huave do të mbështeten nga **Fondi Evropian për Evropën Juglindore**¹⁹ dhe **Fondi i Ballkanit Perëndimor për Novacionin dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve**²⁰. Për sa i përket zhvillimit të politikave, integritit të tregut dhe zhvillimit të eksporteve, asistencë teknike do të mbështetë Shqipërinë në menaxhimin e fondeve të ndryshme kombëtare dhe rajonale në mbështetje të NVM-ve, me qëllim që të optimizohet impakti i tyre dhe të koordinohet financimi që japin donatorët. Kapacitetet e autoriteteve do të forcohen që të zhvillojnë dhe të monitorojnë politikatat dhe zbatimin e tyre. Zhvillimi i **tregut të gazit** do të ndodhë në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

Për më tepër, Shqipëria do të përgatitë një **program për konkurrueshmërinë dhe rritjen**, që do t'ia dorëzojë Komisionit bashkë me programin makroekonomik dhe fiskal të përmendur në pjesën 2 më lart. Komisioni do ta vlerësojë këtë program dhe do të japë udhëzime specifike për politikatat e

¹⁸ Financuar nga Italia

¹⁹ Me mbështetje të BE-së.

²⁰ Me mbështetje të BE-së.

vendit. Kjo përjasje gjithëpërfshirëse ndaj konkurrencës, sidomos koordinimi i disa sektorëve të rëndësishëm për konkurrueshmërinë (transporti, energjetika, punësimi, arsimiti, etj.) do të rezultojë në impakt më të mirë të masave konkrete.

Në lidhje me kushtet për **mbështetjen e fushës**, Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve do të jetë pjesë e SKZHI 2014-2020. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MEDTE) po e udhëheq sektorin. Disa përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve i janë dhënë autoriteteve të pushtetit vendor, pra bashkive dhe komunave. Por, koordinimi i aktiviteteve dhe buxheteve mes pushtetit qendror dhe atij vendor jo gjithmonë është i qartë.

Në tërësi, ekzistojnë kushtet për përjasje sektoriale të mbështetjes për zhvillimin ekonomik. Angazhimi financiar i Shqipërisë manifestohet në programet buxhetore të Ministrive të ndryshme që do të zbatojnë Strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve si edhe strategjitë përkatëse.

5.3. Llojet e financimit

Asistenca do të jepet me projekte binjakëzimi, asistencë teknike, furnizim me pajisje dhe investime, si edhe përmes instrumenteve financiare, mundësisht përmes thirrjeve për projekt-propozime dhe grante direkte për autoritetet kombëtare përkatëse. I përshtatshëm është edhe menaxhimi indirekt me organizata të tjera. Projekte specifike infrastrukturore në këtë sektor mund të financohen edhe në koordinim me WBIF. Do të shikohet edhe mundësia e mbështetjes buxhetore, sidomos për procesin e reformave strukturore, me kusht që Shqipëria të përmbushë parakushtet për mbështetje buxhetore sektoriale. IPA II mund të bashkëfinancojë kontributin e Shqipërisë për pjesëmarrjen e saj në programet përkatëse të BE-së, si p.sh. *Horizon 2020* (kërkim shkencor dhe novacion) dhe *COSME* (konkurrueshmëria e ndërmarrjeve dhe NVM-ve), sapo të konfirmohet dobia e pjesëmarrjes së Shqipërisë në raport me kostot.

5.4 Risqet

Risku për zhvillimin ekonomik, por edhe për turizmin, vjen jo vetëm nga situata makroekonomike në vend, por edhe në rajon dhe te partnerët kryesorë tregtarë. Për këtë arsye, asistenca e BE-së do të konsiderojë diversifikimin e aktivitetit ekonomik si një element i rëndësishëm i zhvillimit strategjik të NVM-ve. Edhe asistenca për zhvillimin e turizmit do të shqyrtojë nevojën për t'iu përshtatur zhvillimeve të tregut.

6. Arsimiti, punësimi dhe politikat sociale

6.1. Nevojat dhe kapacitetet

Objekti i këtij sektori janë sistemet e arsimit që përmirësojnë bazën e aftësive të fuqisë punëtore, përmirësojnë përfshirjen sociale të popullsisë vulnerabil dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të nevojshme për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin.

Asistenca e mëparshme përfshinte zhvillimin e arsimit dhe sistemin e formimit profesional, si në aspektin e përcaktimit të politikave, ashtu edhe në sigurimin dhe ndërtimin e infrastrukturës (shkollat AFP). IPA I mbështeti edhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël dhe minoriteteve, në veçanti romët dhe egjiptianët, përmes ndërhyrjeve të përshtatura në kuadrin e programit kombëtar apo përmes masave të financuara në kuadrin e instrumentit të shoqërisë civile dhe të

Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut. Mbështetja e përgjithshme IPA gjatë periudhës 2007-13 arrin në mbi 24 milion euro. Disa donatorë që ndihmojnë këtë fushë janë Gjermania, Austria, Italia dhe Zvicra, që po plotësojnë programet buxhetore të qeverisë në fushën AFP, punësim dhe politikat sociale. Përfshirja sociale është trajtuar nga disa organizata të tilla si Banka Botërore dhe Kombet e Bashkuara.

Me gjithë përparimin e bërë, Shqipëria ende përballet me **sfida** në këtë sektor. Sfidë kryesore është zhvillimi i mëtejshëm i burimeve njerëzore të vendit, në aspektin e aftësive, kompetencave dhe kualifikimeve në përputhje me nevojat e tregut të punës. Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë në arsim dhe formim profesional të të rinjve dhe të të rriturve duhet të ndërlihet me objektivat e zhvillimit ekonomik dhe rajonal, që në fund të çojë në rritje të punësimit dhe përfshirjes sociale. Sfidë tjetër është edhe rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës, sidomos të grave. Shqipëria duhet të përafrojë më shumë politikat arsimore me politikat e BE-së, p.sh. në lidhje me statistikat, të marrë pjesë në programet përkatëse të BE-së si ERASMUS +, si dhe të zbatojë reformat e Bolonjës, me qëllim që të garantojë krahasueshmërinë në standardet dhe cilësitë e kualifikimeve të arsimit të lartë në Shqipëri.

Për më tepër, shërbimet shëndetësore e sociale dhe infrastruktura në mbështetje të grupeve në nevojë, sidomos të minoriteteve dhe grupeve të tjera (p.sh. personat me aftësi të kufizuara) janë të pamjaftueshme. Qeverisja e mirë në këtë sektor është thelbësore. Aktualisht, pushtetit vendor i mungojnë pajisjet e duhura për realizimin e detyrave në lidhje me më lart. Koordinimi midis ministrive dhe pushtetit vendor është i pamjaftueshëm.

6.2. Objektivat, rezultatet, masat dhe indikatorët

BE-ja do të ndihmojë Shqipërinë me **objektivin** që të rritë impaktin e politikave për punësimin dhe përfshirjen sociale, për sa i përket pjesëmarrjes në tregun e punës dhe mundësive për grupet në nevojë dhe pa përkrahje në aspektin social dhe ekonomik.

Rezultatet e pritshme që do të arrihen me asistencën e BE-së janë:

- Përmirësimi i cilësisë dhe relevancës së sistemit arsimor dhe sistemit të formimit profesional për të zhvilluar aftësitë e fuqisë punëtore në përputhje me perspektivën e rritjes dhe zhvillimit afatmesëm të Shqipërisë;
- Rritje të pjesëmarrjes dhe punësimit në tregun e punës, sidomos për gratë dhe rininë;
- Përfshirje më të mirë të grupeve pa përkrahje dhe në nevojë në tregun e punës;
- Përshtatshmëria dhe efikasitetit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore dhe aksesit në to janë përmirësuar për popullatën në nevojë në bazë të kriterëve objektive dhe transparente, duke eliminuar rreziqet për korrupsion dhe abuzime të tjera;
- Promovim të partneritetit ndërmjet institucioneve të pushtetit vendor dhe shoqërisë civile për ofrimin e shërbimeve sociale;
- Përmirësim të mjaftueshmërisë dhe efikasitetit të shërbimeve shëndetësore dhe sociale për popullatën në nevojë, mbi bazën e kriterëve transparent dhe objektive, duke eliminuar risqet e korrupsionit dhe abuzimeve të tjera.

Indikatorët që do të përdoren për të matur arritjen e rezultateve të pritshme të asistencës së BE-së në këtë fushë përfshijnë (*shih tabelën 2 në Shtojcën 2*):

- Progresi i bërë në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit (KE);

- Shkalla e punësimit e popullsisë 15-64 vjeç, % totale (Eurostat);
- Shkalla e punësimit e popullsisë 15-64 vjeç, % femra (Eurostat).

Lidhur me **masën** që do të mbështetet, asistenca e BE-së do të trajtojë ndërtimin e kapaciteteve dhe nevojat e politikave të reformave në lidhje me cilësinë dhe gjithëpërfshirjen në zhvillimin e burimeve njerëzore të vendit. BE mund të mbështetë më tej konsolidimin e zhvillimit të infrastrukturës arsimore, sapo të përmbushen kushtet për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin adekuat të pajisjeve dhe infrastrukturës.

Fusha e përfshirjes sociale kërkon mbështetje të konsiderueshme përveç asistencës teknike, në mënyrë që të përmirësohen kushtet e jetesës sipas standardeve evropiane të grupeve në nevojë dhe pa përkrahje, sidomos për komunitetin rom dhe egjiptian. Në këtë drejtim, BE-ja mund të mbështesë reformat e nevojshme për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe strehimin social. Kjo asistencë do të bazohet në strategjinë sektoriale për punësimin dhe aftësitë, dhe duhet të jetë e realizueshme dhe e përballueshme nga ana financiare.

Në lidhje me kushtet për **mbështetjen e fushës**, strategjitë sektoriale përkatëse, d.m.th. Strategjia e Punësimit dhe Aftësive dhe edhe Strategjia për Përfshirjen dhe Mbrojtjen Sociale pritet të miratohen në kuadrin e SKZHI 2014-2020. Kushtet janë për të zhvilluar programe sektoriale përkatësisht për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe përfshirjen sociale. Nëse është e mundur, asistenca do të jepet me kontrata për reformimin e sektorit (mbështetje buxhetore sektoriale).

6.3. Llojet e financimit

Mbështetja buxhetore sektoriale do të jetë lloji i preferuar i financimit, nëse plotësohen kushtet. Deri në atë moment, asistenca e BE-së do të përfshijë asistencë teknike përmes kontratave të shërbimit, TAIEX-it apo të tjera. Asistenca mund të zbatohet në kombinim me financime të donatorëve tjerë, veçanërisht nga IFN-të, dhe mund të përfshijnë bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile. Për sa i përket mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, dhe me një politikë aktive integrimi në tregun e punës, BE-ja parashikon bashkëpunim të ngushtë me donatorët e tjerë në këtë fushë, për të siguruar mbështetje efikase për grupet në nevojë dhe për të promovuar punësimin, prodhimtarinë dhe mundësitë. Pjesëmarrja në programet përkatëse të BE-së do të përkrahet dhe detajet do të vendosen në periudhën e programimit.

6.4. Risqet

Risqet për arritjen e objektivit të synuar kanë të bëjnë me burimet financiare dhe njerëzore në dispozicion. Monitorimi dhe raportimi intensiv mund të ndihmojë në zbutjen e këtyre risqeve. Gjithashtu, faktorë të jashtëm ndikojnë në punësim, sidomos për punëtorët emigrantë që janë kthyer pas krizës ekonomike në vendet fqinje. Mundësitë për të zbutur këto risqe janë të pakta.

7. Bujqësia dhe zhvillimi rural

7.1. Nevojat dhe kapacitetet

Fushëveprimi i këtij sektori përfshin (a) aftësinë e sektorit agro-ushqimor për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut, si edhe për t'u përafruar gradualisht me rregullat

dhe standardet e BE-së; (b) rritjen e aftësisë përbaluese të efekteve negative të ndryshimeve klimatike; (c) sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe politikat fitosanitare.

Asistenca e mëparshme nën IPA I përfshinte mbështetje për përgatitjen e politikave sektoriale, me fokus të veçantë ndërtimin e kapaciteteve për ngritjen e strukturave administrative për menaxhimin e ardhshëm të programeve të zhvillimit rural (IPARD) nën IPA II. Kapacitetet janë konsoliduar me metodën e të nxënimit aktiv, ku strukturat kombëtare bashkë me ekspertizën e jashtme dhanë fonde për bashkëfinancimin e masave të IPARD-like, d.m.th. investime në shkallë të vogël dhe të mesme në sektorin agro-ushqimor. IPA I u fokusua edhe në forcimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë ushqimore dhe shërbimeve veterinare, përfshi përmirësimin e infrastrukturës laboratorike vendore dhe kombëtare. Në tërësi, IPA I dha rreth 90 milion EUR për sektorin. Donatorë të tjerë që mbështesin bujqësinë dhe zhvillimin rural janë Banka Botërore, agjencitë e OKB-së, Gjermania, Suedia dhe Italia.

Me gjithë progresin e bërë deri tani, Shqipëria vazhdon të përballet me **sfidën** e prodhueshmërisë së ulët të bujqësisë dhe zonat rurale të nënzhvilluara. Fermerët dhe operatorët e agrobiznesit ende nuk janë të përgatitur mirë për të menaxhuar mundësitë dhe sfidat që vijnë nga integrimi në tregjet bujqësore dhe politikat e BE-së. Aktualisht, bujqësia është e orientuar drejt nevojave të familjes dhe ferma mesatare është e vogël për shkak të copëzimit të tokës²¹. Koncepti “fermer” nuk është i ezauruar në legjislacion. Bujqësia kërkon punë intensive me nivel të ulët produktiviteti dhe efikasiteti të punës dhe efikasitetit si pasojë e nivelit të ulët të përparimit teknologjik dhe përdorimit të pakët të ekspertizës. Investimet në sektorin agro-ushqimor janë të pakta. Shërbimet këshillimore dhe të ekstensionit janë të dobëta dhe sistemet e informacionit bujqësor nuk janë të zhvilluara mirë (regjistri i tokës, regjistrat funksionalë të fermave dhe kafshëve). Harmonizimi i mëtejshëm me legjislacionin e BE-së në mënyrë që të optimizohet aksesin në tregun e BE-së dhe të shfrytëzohen mundësitë ende nuk është siguruar për sa i përket sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fushave të tjera të lidhura me to. Shqipërisë i mungon legjislacioni funksional cilësor për politikat (bujqësia organike, mbrojtja e treguesve gjeografikë).

Financimi bujqësor mbetet i kufizuar, krahasuar me nevojat e sektorit dhe me vendet e rajonit. Masat kombëtare mbështetëse japin subvencione për prodhimin aktual dhe nuk nxitin konkurrencën apo të lehtësojnë aksesin në kreditim. Kapaciteti administrativ i vendit mbetet i ulët. Shqipëria duhet të zgjerojë kapacitetin administrativ që të jetë në gjendje për të përafuar legjislacionin dhe instrumentet e politikave të saj me *acquis* të BE-së.

As publiku dhe as prodhuesit nuk kanë njohuri të mjaftueshme të standardeve të mjedisit dhe sigurisë ushqimore në bujqësinë dhe përpunim artikujsh ushqimorë bazë. Vazhdon të jetë i ulët respektimi i standardeve mjedisore, p.sh. në aplikimin e kimikateve bujqësore dhe standardet e sigurisë ushqimore, p.sh. stabilimentet ku trajtohen nënproduktet shtazore. Mungon infrastruktura relevante dhe funksionale. Përveç kësaj, rritja e ndjeshmërisë së ekosistemeve, sistemeve të furnizimit me ujë dhe infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike ndikon direkt negativisht në prodhimin bujqësor.

²¹ Përmasa mesatare e njësive ekonomike bujqësore është 1.26 ha, me madhësi mesatare parcele 0.27 ha.

Për sa i përket peshkimit, nuk ka një politikë të qartë dhe të strukturuar që garanton menaxhim të mirë të burimeve, ndalim të peshkimit të paligjshëm dhe të parregulluar, si edhe prodhim dhe përpunim të qëndrueshëm të peshkut. Standardet e sigurisë ushqimore duhet të përmirësohen.

7.2. Objektivat, rezultatet, masat dhe indikatorët

Asistenca e BE-së do të ndihmojë Shqipërinë në zhvillimin e një sektori agro-ushqimor efikas, të qëndrueshëm dhe novator, që të jetë konkurrues në tregun e BE-së dhe të ofrojë punësim, përfshirje sociale dhe cilësi jetese për popullsinë rurale.

Rezultatet që pritet të arrihen me asistencën e BE-së janë:

- Ngritja e strukturave kombëtare përgjegjëse për zbatimin e buxhetit të asistencës për zhvillimin bujqësor dhe rural (zbatojnë programet IPARD);
- Ngritja dhe mirëfunksionimi i sistemeve informative digjitale dinamike të bujqësisë (përditësimi i vazhdueshëm i regjistrave digjitalë të tokës, fermave dhe kafshëve);
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve këshillimore bujqësore;
- Rritja e të ardhurave të gjeneruara nga gratë dhe të rinjtë sipërmarrës;
- Përmirësimi i përbalimit të efekteve negative të ndryshimeve klimatike;
- Përmirësimi i aplikimit të standardeve të mjedisit dhe sigurisë ushqimore në tërë zinxhirin agro-ushqimor, sidomos në prodhimin e mishit dhe produkteve të baxhos, si edhe të produkteve për eksport;
- Përmirësimi i menaxhimit dhe mbrojtjes së burimeve të peshkimit në linjë me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE-së.

Indikatorët që do të përdoren për të matur arritjen e rezultateve të pritshme janë (shih Tabelën 2 të Shtojcës 2):

- Progresi i bërë në arritjen e kriterëve të anëtarësimit (KE);
- Totali i investimeve të gjeneruara nga IPA II në sektorin agro-ushqimor dhe zhvillimin rural (DG AGRI).

Për sa i përket **masave**, mbështetja e BE-së përfshin asistencë teknike për të vazhduar ndërtimin e kapaciteteve të organeve që merren me zhvillimin bujqësor dhe rural, përfshi peshkimin. Kjo përfshin asistimin e Shqipërisë në përgatitjen e saj për zbatimin e IPARD-it, shërbimet e ekstensionit dhe këshillimore, organet teknike të ngarkuara me cilësinë dhe sigurinë ushqimore, formulimin e politikave bujqësore, statistikat bujqësore, sistemet e menaxhimit informativ, prodhimi dhe përpunimi i qëndrueshëm i peshkut, si edhe në përmirësimin e standardeve të sigurisë ushqimore, si edhe menaxhimin e sektorit të peshkimit.

Mbështetja e BE-së i kushton rëndësi të veçantë kapaciteteve administrative për zbatimin e programeve të zhvillimit rural në përputhje me politikat e BE-së, përfshi menaxhimin financiar të shëndoshë dhe marrjen e akreditimit nga këto struktura menaxhuese. Para se të arrihet akreditimi, IPA II do të japë asistencë për fermerët dhe operatorët e tjerë të agro-biznesit si përfitues potencialë fundorë, me qëllim që të arrihet në sisteme bujqësore rentabël dhe pjesëmarrje e suksesshme në programin e ardhshëm të zhvillimit rural IPA II. Masat specifike do të zgjidhen gjatë periudhës së programimit.

Për sa i përket kushteve për **përqasje sektoriale**, është hartuar strategjia për zhvillimin bujqësor dhe rural, e cila duhet të plotësohet me një program për zhvillimin rural në përputhje me politikat e BE-së. Strukturat administrative duhet të forcohen më tej për të garantuar akreditim të suksesshëm. Parashikohet që Programi i Zhvillimit Rural i plotë të jetë gati gjatë pjesës së parë të IPA II (2014-2017).

Është ngritur struktura operuese për zbatimin e asistencës së para-anëtarësimit në fushën e zhvillimit rural, e cila është fuqizuar vitet e fundit. Stafi ka marrë trajnim të qenësishëm, kryesisht nëpërmjet projekteve të asistencës teknike dhe TAIEX-it. Kuadri institucional dhe ligjor i sistemit të sigurisë ushqimore është përditësuar. Dy fushata masive vaksinimi ndaj brucelozës në të imtat kanë reduktuar përhapjen e sëmundjes, ndërsa vaksinimi ndaj tërbimit ka reduktuar rrezikun e përhapjes më tej të sëmundjes jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet fqinje.

Çështjet e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitetit do të trajtohen me masa individuale gjatë periudhës së parë të IPA II (2014-2017). Më pas do të aplikohet një përfaqje sektoriale e plotë, nëse kushtet e lejojnë.

7.3. Llojet e financimit

Reforma dhe procesi i ndërtimit të kapaciteteve administrative do të mbështetet me binjakëzime dhe kontrata shërbimesh dhe furnizimi, nëse është e mundur. Kontratat e grantit mund të aplikohen për të mbështetur shërbime të tjera. Organizata të tjera mund të japin mbështetje në menaxhimin indirekt.

Mbështetja IPA II me Shumë Përfitues në fushën e zhvillimit rural do të jepet përmes masave të financuara nga Programi i Zhvillimit Rural (IPARD), sapo programi të jetë operacional. IPARD-in e menaxhon Shqipëria me menaxhim indirekt.

7.4. Risqet

Risqet në këtë sektor lidhen me ndjeshmërinë politike, burimet në dispozicion, si edhe masat zbutëse përmes përmirësimit të monitorimit dhe raportimit. Gjithashtu, ka risqe që vonojnë reformat në të drejtat e pronësisë, që ndikojnë në zhvillimin e tregjeve të tokës, të cilat vetë kufizojnë aksesin në kreditim dhe rrjedhimisht zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale.

Për më tepër, sensibilizimi i ulët në shoqërisë në përgjithësi dhe i operatorëve agro-ushqimorë në lidhje me standardet mjedisore dhe standardet e sigurisë ushqimore, vënë në rrezik pranimin e reformave. Një përgjigje ndaj këtij risku mund të jetë rritja e sensibilizimit, duke qenë të ndjeshëm ndaj kontekstit kulturor dhe ekonomik.

8. Bashkëpunimi territorial dhe bashkëpunimi rajonal

8.1. Nevojat dhe kapacitetet

Në periudhën 2014-2020, Bashkimi Evropian do të financojë disa programe për bashkëpunim ndërkufitar (BNK) territorial. Bashkëpunimi synon nxitjen e pajtimit dhe fqinjësisë së mirë, si dhe

forcimin e zhvillimit të qëndrueshëm vendor përmes rritjes së shanseve për përmirësimin e begatisë në zonat e largëta dhe rurale kufitare, të cilat janë zakonisht më të prapambetura ekonomikisht. Prandaj, programet ndërkufitare synojnë të adresojnë sfidat e përbashkëta në fushat e konkurrueshmërisë ekonomike, përfshirjes sociale, mbrojtjes së mjedisit e trashëgimisë kulturore dhe promovimit të turizmit.

Mësimet kryesore të nxjerra mbi bashkëpunim territorial janë evidentuar në dy vlerësime të ndërmjetme në vitin 2010 dhe 2011 dhe do të përdoren në kuadër të IPA II për programet që përfshijnë Shqipërinë dhe fqinjët e saj. Kuadri institucional që rregullon programet ndërkufitare IPA II do të thjeshtohet me një autoritet kontraktues të vetëm për programin, një buxhet i vetëm financiar për programin, si dhe më pak prioriteteve tematike, për të siguruar më shumë fokus dhe më shumë ndikim.

Shqipëria do të marrë pjesë edhe në programe ndërkufitare me Shtetet Anëtare të BE-së dhe programet transnacionale e rajonale, që do të financohen me kontribute nga Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal dhe IPA II. Kjo është një mundësi për aplikantët shqiptarë (p.sh. institucionet rajonale dhe vendore, organizatat e shoqërisë civile, universitetet, etj.) për t'u ushtruar me rregullat dhe procedurat e nismave të bashkëpunimit territorial dhe për të zgjeruar rrjetin e partnerëve të mundshëm për aktivitetet e bashkëpunimit rajonal.

8.2. Objektivat, rezultatet, masat dhe indikatorët

Shqipëria do të marrë pjesë në tre programet ndërkufitare IPA II me përfitues të tjerë IPA, sidomos Malin e Zi, Kosovën dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Secili program përqendrohet në tri prioritete tematike. Mbrojtja e mjedisit, ndryshimet klimatike dhe parandalimi i rreziqeve, si dhe turizmi dhe trashëgimia kulturore janë prioritete tematike të përbashkëta për të tre programet. Programi me Malin e Zi dhe programi me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë do të përqendrohen te konkurrenca, biznesi, tregtia dhe investimet si prioritet tematik i tretë, ndërsa programi me Kosovën do të fokusohet te rinia dhe arsimi.

Për sa i përket fushëveprimit të tyre, objektivat specifike për prioritet tematike të çdo programi ndërkufitar janë të përcaktuar në një dokument planifikimi 7-vjeçar të dedikuar, i hartuar në bazë të konsultimit të gjerë me aktorët vendorë. Dokumenti i programimit shumëvjeçar parashikon buxhet indikativ për çdo prioritet tematik, përcakton një sërë indikatorësh për matjen e ndikimit të programit, identifikon fushat specifike të pranueshme për financim, dhe jep informacion mbi modalitetet e zbatimit (p.sh. thirrjet për aplikime).

Për sa i përket programeve me Shtetet Anëtare, Shqipëria do të marrë pjesë në një program ndërkufitar trepalësh me Italinë dhe Malin e Zi, si dhe në një program dypalësh me Greqinë. Secili program IPA BNK me Shtetet Anëtare do të përqendrohet maksimumi në katër prioriteteve tematike të renditura në Shtojcën III të Rregullores IPA II²², që do të zgjidhen bashkërisht nga vendet e përfshira në program sipas situatës së veçantë të rajonit kufitar.

²² (1) promovimi i punësimit, lëvizshmëria e punës dhe përfshirja sociale dhe kulturore; (2) mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes ndaj dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i riskut; (3) promovimi i transportimit të qëndrueshëm dhe përmirësimi i infrastrukturave publike; (4) inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore; (5) investimi te rinia, arsimi dhe aftësitë; (6) promovimi i qeverisjes vendore dhe rajonale,

Gjatë periudhës 2014-20, Shqipëria do të vazhdojë të marrë pjesë në programin transnacional të Mesdheut dhe do të aderojë edhe në programin e ri Adriatik-Jon. Të dy programet kanë një shtrirje mjaft të gjerë gjeografik, përfshijnë disa shtete dhe mbulojnë të gjithë territorin e Shqipërisë si zonë përfituese për financim.

Programi i Mesdheut bazohet në disa fusha tematike, si: i) shpërndarja e teknologjive të reja dhe dijes; ii) mbrojtja e burimeve natyrore dhe e trashëgimisë kulturore, si dhe efikasiteti i energjisë dhe energjia e rinovueshme; iii) aksesueshmëria dhe siguria detare; iv) përmirësimi i sistemeve të qeverisjes territoriale. Aplikantët shqiptarë kanë filluar të krijojnë kontakte dhe rrjete me partnerët ndërkombëtarë në kuadër të programit të mëparshëm. Me programet 2014-2020, pritet të shtohet pjesëmarrja e Shqipërisë në nisma të suksesshme.

Bashkimi Evropian po miraton një Strategji për rajonin e Jonit dhe Adriatikut (EUSAIR)²³. Prandaj, gjatë periudhës 2014-2020, Komisioni ka planifikuar të shpallë një program transnacional enkas për këtë makro-rajon, që do të ushqejë zbatimin e strategjisë. Projektet e bashkëpunimit transnacional do të përqendrohen në katër shtylla tematike të planit të veprimit EUSAIR: i) rritje detare dhe ujore novatore; ii) lidhja me tërë rajonin; iii) ruajtja e mjedisit; iv) rritja e atraktivitetit rajonal.

planifikimit dhe forcimit të kapaciteteve administrative; (7) forcimi i konkurrueshmërisë, zhvillimi i biznesit dhe NVM-ve, tregtisë dhe investimeve; (8) forcimi i kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik, novacionit dhe TIK-ut.

²³ Shih më lart, pjesa 2, seksioni 2.2. "Strategjitë kombëtare/rajonale relevante".

SHTOJCA 1: ALOKIMET INDIKATIVE (milion EUR)²⁴ sipas fushës dhe sektorit

SHQIPËRIA	2014	2015	2016	2017	2018-2020	Total 2014-2020	Relevante për ndryshimet klimatike (%) **
a. Reformat në përgatitje për anëtarësimin në BE	78.7	59.9	12.7	74.9	94.3	320.5	
Demokracia dhe qeverisja	157.2				66.3	223.5	
Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore	69.0				28.0	97.0	
b. Zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal	0	18.0	50.0	0	100.0	168.0	
Mjedisi	34.0				34.0	68.0	66%
Transporti	18.0				38.0	56.0	27%
Energjetika	0.0				0.0	0.0	
Konkurrueshmëria dhe novacioni	16.0				28.0	44.0	9%
c. Punësimi, politikat sociale, arsimi, promovimi i barazisë gjinore dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	5.0	0	14.0	0	50.0	69.0	
Arsimi, punësimi dhe politikat sociale	19.0				50.0	69.0	
d. Bujqësia dhe zhvillimi rural	0	9.0	13.0	18.0	52.0	92.0	
Bujqësia dhe zhvillimi rural	40.0				52.0	92.0	26%
TOTALI	83.7	86.9	89.7	92.9	296.3	649.4	

²⁴ Diferencat e mundshme në shifrat e paraqitura sipas fushës dhe sektorit krahasuar me totalet vjetore janë si pasojë e rumbullakosjes deri në një të dhjetat.

SHTOJCA 2: INDIKATORËT DHE OBJEKTIVAT

Tabela 1a: Indikatorët e kontekstit

INDIKATORI	Burimi	Viti bazë	Vlera e fundit	
		2010	Viti	Vlera
Borxhi publik (% e PBB-së)	<u>Eurostat</u>	58.52	2012	63.54
Norma e rritjes reale të PBB-së (mesatarja e tre viteve të fundit - %)	<u>Eurostat</u>	3.7 (p)	2012	1.64 (ep)
Norma e rritjes reale të PBB-së (mesatarja e tre viteve të fundit - %)	<u>Eurostat</u>	14,04 (e)	2012	13.92 (e)
Norma e rritjes reale të PBB-së (mesatarja e tre viteve të fundit - %)	<u>Eurostat</u>	3,106.00 (p)	2012	3,344.00
Norma e rritjes reale të PBB-së (mesatarja e tre viteve të fundit - %)	<u>Eurostat</u>	276.4	2012	264.5

(e) e llogaritur

(p) provizore

Tabela 1b: Indikatorët e rezultateve dhe impaktit

INDIKATORI	Burimi	Viti bazë	Vlera e fundit		Standardi*	Objektivi*
		2010	Viti	Vlera	2017	2020
Indikator i përbërë (renditja mesatare nga tetë burime të jashtme: Barometri i Korrupsionit, Kontrolli i Korrupsionit, Liria e Shtypit, Liria për Shtyp, Shteti i së Drejtës, Efektiviteti i Qeverisë, Zëri dhe Përgjegjshmëria, dhe Cilësia Rregullatore)	DG ELARG	49	2012	44.9		
Progresi i bërë në arritjen e Kriterit Politik	ELARG – Progres Raporti					
Progresi i bërë në zbatimin e <i>acquis</i>	ELARG – Progres Raporti					
Progresi i bërë në arritjen e Kriterit Ekonomik	ELARG – Progres Raporti					

* standardet dhe objektivat do të jepen në një fazë të mëvonshme.

Tabela 2: Indikatorët Sektorialë

Sektori	Nësektori	Indikatori	Burimi	Viti bazë	Vlera e fundit		Standardi*	Objektivi*
				2010	Viti	Vlera	2017	2020
Qeverisja dhe Demokracia	Qeverisja dhe RAP	Progresi i bërë në arritjen e kriterëve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Indikator i përbërë (mesatarja e Efektivitetit të Qeverisë, Barra e Rregullimit Shtetëror dhe Cilësia Rregullatore - 1 (më e keqja) – 100 (më e mira))	Banka Botërore, Forumi Ekonomik Botëror	53.20	2012	53.23		
	MFP dhe prokurimi publik	Progresi i bërë në arritjen e kriterëve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Stoku i detyrimeve të prapambetura të shtetit ndaj biznesit	Anketa e Deloitte e porositur nga Ministria e Financave në T4 2013	N/A	2013	72.57 miliard Lek		
	Statistikat	Progresi i bërë në arritjen e kriterëve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Përputhshmëria statistikore - % 0 (më e keqja) – 100 (më e mira)	<u>Eurostat</u>	12% /18% (2013)				
Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore	Reforma në Gjyqësor	Progresi i bërë në arritjen e kriterëve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Indikator i përbërë (mesatarja e Aksesit në Drejtësi pavarësia e Gjyqësorit)	Projekti i Drejtësisë Botërore, Forumi Ekonomik Botëror	53.79	N/A	N/A		
	Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar	Progresi i bërë në arritjen e kriterëve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Indikator i përbërë (mesatarja e Korrupsionit Global dhe Kontrolli i Korrupsionit) - 1 (më e keqja) – 100 (më e mira)	Transparency International, Banka Botërore	33.83	2012	29.90		
	Të drejtat themelore	Progresi i bërë në arritjen e kriterëve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Indikator i përbërë (mesatarja e Lirisë së Shtypit dhe Lirisë për Shtypin) 1 (më e mira) – 100 (më e keqja)	Freedom House, Reporterët pa Kufi	35.75	2012	41.72		
	Refugjatët dhe	Progresi i bërë në arritjen e kriterëve të	DG ELARG – Progres					

	menaxhimi i kufijve	anëtarësimit	Raporti					
Mjedisi		Progresi i bërë në arritjen e kritereve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Popullsia e lidhur me sistemet e grumbullimit të ujërave të ndotura	Statistikat kombëtare					
Transporti		Progresi i bërë në arritjen e kritereve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Indikatori i performancës së logjistikës 1 (më e keqja) – 5 (më e mira)	<u>Banka Botërore</u>	N/A	2012	2.43		
Konkurreshmëria dhe novacioni			DG ELARG – Progres Raporti					
		Të bërit biznesit – Distanca nga kufiri 1 (më e mira) – 100 (më e keqja)	<u>Banka Botërore - Doing Business</u>	63.79	2012	59.46		
Arsimi, punësimi dhe politikat sociale		Progresi i bërë në arritjen e kritereve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Shkalla e punësimit (15-64 vjeç) femra %	<u>Eurostat</u>	44.4 (e)	2012	49.58 (e)		
		Shkalla e punësimit (15-64 vjeç) total %	<u>Eurostat</u>	53.49 (e)	2012	56.40 (e)		
Bujqësia		Progresi i bërë në arritjen e kritereve të anëtarësimit	DG ELARG – Progres Raporti					
		Totali i investimeve të gjeneruara nga IPA II në sektorin agro-ushqimor dhe zhvillimin rural (EUR)	DG Agri					
Bashkëpunimi territorial dhe bashkëpunimi rajonal		Numri i bashkive të përfshira	Sistemi Informativ i Menaxhimit i Komisionit Evropian					

* standardet dhe objektivat do të jepen në një fazë të mëvonshme.

(e) e llogaritur.